



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim
dhe Bashkëpunim SDC



RAPORT

PËRDORIMI I DREJTË I PARASË PUBLIKE NË PUSHTETIN LOKAL PËRMES ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE TË KLSH

Elbasan, Lushnje, Pogradec, Prrenjas, Maliq

2017-2018

Financuar: Agjencia Zviceriane për Zhvillim dhe
Bashkëpunim nëpërmjet Lëviz Albania

Zbatuar: QTIL



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim
dhe Bashkëpunim SDC



RAPORT

PËRDORIMI I DREJTË I PARASË PUBLIKE NË PUSHTETIN LOKAL PËRMES ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE TË KLSH

Elbasan, Lushnje, Pogradec, Prrenjas, Maliq

2017-2018

Financuar: Agjencia Zviceriane për Zhvillim dhe
Bashkëpunim nëpërmjet Lëviz Albania

Zbatuar: QTIL

PËRMBAJTJA

Hyrje	7
Metodologjia	8
Monitorimi i bashkive	10
Gjetjet dhe rekomandimet	37

HYRJJE

KLSH është një institucion që kontrollon mënyrën se si institucionet publike, pra edhe bashkitë, menaxhojnë buxhetin. Në bazë të gjetjeve, KLSH jep rekomandime që atakojnë abuzimet me paratë e publikut, korrupsionin dhe shkeljen e ligjeve.

Bashkitë janë institucione që menazhojnë në mënyrë të pavarur paratë publike. Gjatë procesit të alokimit të parave dhe implementimit të projekteve apo shërbimeve hasen shkelje ligjore, abuzime, vjedhje dhe korrupsion. Duke qenë institucione të pavarur, kontrolli nuk është intensiv.

Nga monitorimet e mëhershme (2015, QUIL) është gjetur se vetem 38.5 për qind e rekomandimeve të KLSH zbatohen nga institucionet publike.

Vetëm përgjatë procesit të prokurimit në këto institucione janë evidentuar shkelje të tilla si më poshtë: ndryshimin e kushteve kontraktore pas shpalljes së ofertës fituese; çlirimin e garancisë së kontraktorit pa plotësuar detyrimin kontraktor; zhvillimin e procedurës “Negocim pa botim paraprak të njoftimit të kontratës”; tejkalimin e kompetencave në prokurime për autoritete të tjera kontraktore; ndarja e fondeve për të kaluar në prokurim të drejtëpërdrejtë etj.

Disa nga ligjet që janë shkelur në mënyrë sistematike janë: Ligji “Për organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore”; Ligji “Për Pyjet dhe Shërbimin Pyjor”; Ligji “Për Fondin Kullosor”; Ligji “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës”; Ligji “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”; Ligji “Për prokurimet”; Ligji “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në republikën e Shqipërisë”; Ligji “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”; Ligji “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”; Ligji: “Për mbrojtjen e mjedisit”; Ligji “Për rregullat e etikës në administratën publike”; Ligji “Për parandalimin e konfliktit të interesave”, etj.

Po ashtu janë shkelur edhe VKM si: VKM “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”; VKM “Mbi rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e Programit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit”; VKM “Për administrimin, dokumentimin dhe qarkullimin vlerave materiale dhe monetare”; apo udhëzime si: UKM “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”; UKM “Për masat në zbatim të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit, Auditit të Brendshëm dhe Departamentit të Kontrollit të Brendshëm Administrativ dhe Antikorrupsion, në Këshillin e Ministrave, në institucionet në varësi të Kryeministrit a të ministrave”, etj.

Disa nga arsyet se pse rekomandimet nuk zbatohen të gjetura nga projekti i mëhershëm i QUIL (2015) prekin zona të ndryshme të menaxhimit të institucioneve publike, mes tyre edhe bashkive të tilla si: zbatimi i plotë i rekomandimeve shpesh varet nga politika dhe vullneti i titullarit; institucionet e audituara nuk lëshojnë plan veprimi por urdhër i cilin nuk është smart; rekomandimet me problematika të mëdha që lidhen me korrupsionin nuk evidentohen si të tilla; mosmarrëveshje për rekomandime të caktuara nuk diskutohen rregullisht, etj.

Në mënyrë që të sigurohet një mbikëqyrje rreth zbatimit të rekomandimeve QUIL sugjeroi në vitin 2015 një rregullore apo udhëzim të vecantë rreth mbikëqyrjes së zbatimit të rekomandimeve nga KLSH, udhëzim i cili u miratua nga KLSH në fund të projektit.

Projekti që u zbatua nga QUIL synon të rritë numrin e rekomandimeve që zbatohen nga bashkitë përmes evidentimit të pengesave që cojnë në mungesën e zbatimit të tyre. Qëllimi i projektit është rritja e përgjegjshmërisë së bashkive dhe institucioneve të varësisë për zbatimin e ligjit, forcimi i luftës kundër korrupsionit dhe rritja e transparencës.

METODOLOGJIA

Qendra për Transparencë dhe Informim të Lirë, (QTIL) ka përzgjedhur të monitorojë 5 bashki të audituara nga KLSH përgjatë vitit 2016 dhe konkretisht:

- 1.Maliq
- 2.Pogradec
- 3.Prrenjas
- 4.Elbasan
- 5.Lushnjë

Bashkitë janë përzgjedhur nga lista e auditimeve të KLSH në institucionet e pushtetit lokal gjatë vitit 2016. KLSH ka kontrolluar gjithsej 32 institucione lokale. Projekti ka përzgjedhur 20% e institucioneve të audituara ose 5 institucione të cilat përfaqësojnë të gjitha llojet e bashkive për nga klasifikimi dhe problematikat e menaxhimit të parase publike.

Për këto 5 Bashki u nxorën disa tregues që lidhen me auditimin nga KLSH por edhe tregues sociale dhe ekonomikë.

-Për 5 bashkitë, janë rekomanduar 113 *masa organizative* nga 627 masa organizative të rekomanduara ngadepartamenti i auditimit të pushtetit vendor.. Grupi i rekomandimeve që verifikohen është sa 18% e të gjithë masave

-Për 5 bashkitë janë rekomanduar masa *shpërblim dëmi* në vlerën 195,765 mijë lekë, nga 1,133,168 mijë lekë, ose në masën 17%.

- Për 5 bashkitë janë rekomanduar 91 *masa disiplinore dhe administrative*, nga 741 masa të rekomanduara gjithsej, ose në masën 13 %

Për 5 bashkitë janë *kallëzuar penalisht* 20 persona, nga 81 persona në 20 subjekte të kallëzuar penalisht.

Për të patur një tablo më të qartë në lidhje me këto 5 bashki, u nxorën edhe disa tregues shtesë dhe konkretisht:

-Këto 5 bashki kanë patur në dispozicion gjithsej 3.409,429 mijë lekë fonde, nga 46,248,340 mijë lekë që kanë qënë në dispozicion të 61 Bashkive ose 7.4% e fondeve gjithsej (Transferuat e pa kushtëzuara dhe nga të ardhurat e taksave dhe tarifave vendore nga të cilat 29,376,538 mijë leke nga fondet e pakushtëzuara dhe 16,371,517 mijë lekë nga të ardhurat e taksave dhe tarifave vendore).

Në përbërje të këtyre 5 bashkive janë 38 njësi administrative me 376 fshatra. Sipas gjendjes civile më datën 01.01.2016 janë të regjistruar një komunitet prej 156,055 familje ose 520,804 banorë, të cilat zënë rreth 12% të gjithë popullsisë mbi të cilin është bërë shpërndarja e fondeve të pakushtëzuara prej 4.335,159 banore (nga 2.8 milion banorë që raporton ISTATI sipas regjistrimit të fundit të popullsisë në vitin 2011)

Zbatimi i projektit u krye përmes një metodologjie që mbështetet në tri shtylla kryesore:

1.Shtylla e parë. Monitorimi I zbatimit te rekomandimeve ne pese bashki permes “desk research” mbi rekomandimet e dhëna nga KLSH për bashkitë në monitorim. Rekomandimet u seleksionuan në: administrative, disiplinore, shpërblimin e dëmit. Për secilin nga rekomandimet u shënuar statusi i tyre në fillim dhe në fund të projektit: rekomandimeve të zbatuara, rekomandimet pjesërisht të zbatuara dhe rekomandimet që nuk janë zbatuar si dhe arsyet se pse ato nuk janë zbatuar.

Monitorimi ka vecuar natyrën e shkeljeve duke i ndarë ato në kategori; gabime ligjore, dobësitë organizative dhe mundësi për korrupsion dhe duke vecuar këtë të fundit. Baza e të dhënave ndihmoi monitoruesit për të ndjekur gjithë projektin ndërsa drejtorin e projektit si edhe ekspertin për të identifikuar rastet për ndërhyrje. Duke pasur një pasqyrë të qartë të problemeve të identifikuara, bashkitë rritin në mënyrë të dukshme numrin i rekomandimeve të zbatuara.

Skuadra e projektit ishte e mirëtrajnuar në lidhje me ligjin për KLSH, ligjin për të drejtën e Informimit, udhëzimin e KLSH për zbatimin e rekomandimeve dhe një varg ligjesh që lidhen me funksionimin e pushtetit lokal.

Ndërtimi i bazës së të dhënave u realizua përmes marrjes së informacionit nga bashkitë për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-se, vetë KLSH-së dhe takimeve me zyrtarë të ndryshëm të bashkive. Marrja e informacionit u bazua në ligjin për të Drejtën e Informimit.

Për të lehtësuar komunikimin me KLSH, QTIL shfrytëzoi marrëveshjen që ka me këtë institucion që nga viti 2012 çfarë çoi në lëshimin e urdhërit të kryetarit të KLSH për ngritjen e një grupi pune që do i atashohej nevojave të projektit përgjatë gjithë zbatimit të tij.

2.Shtylla e dyte e metodologjise ka te beje me advokimin nepermjet ballafaqimeve publike midis bashkise, shoqerise civile, KLSH-se dhe aktoreve te tjere (prokurori, etj) per zbatimin e rekomandimeve te KLSH-se përmes tryezave ku marrin pjesë përfaqësues të qendrës, bashkisë, KLSH , organizatave lokale të shoqërisë civile, grupe interesi, përfaqësues të medias apo aktivistë të ndryshëm, tryeza në të cilat do të publikohen gjetjet në lidhje me korrupsionin në bashki me synim ndërtimin e presionit për zbatimin e ligjit nga administrat vendore por edhe institucionet ligjzbatuese; si dhe përmes publikimit ne mediat lokale/kombëtare dhe rrjeteve sociale të rasteve të përzgjedhura nga shkeljet e konstatuara prej KLSH në bashkitë e përzgjedhura për monitorim.

Në fund të fazës së parë të projektit, gjetjet e tij u dërgohen bashkive përkatëse dhe në KLSH. Bashkë më gjetjet do të formulohen edhe propozimet dhe rekomandimet me synim përmirësimin e zbatimit në kohë dhe cilësi të rekomandimeve të KLSH.

MONITORIMI I BASHKIVE

1. Bashkia Maliq:

Bashkia Maliq është përgjigjur në afatet ligjore në lidhje me kërkesat e QTIL për informacion.

Të dhëna të përmbledhura:

Në fillim të projektit: 38 masa të rekomanduara nga të cilat janë pranuar 35 masa, 7 masa të plotësuara, 4 masa janë zbatuar pjesërisht dhe 27 masa të pa zbatuara

Në fund të projektit: nga 38 masa të rekomanduara janë pranuar 35 masa, prej tyre janë zbatuar plotësisht 16 masa, ndërkohë që konsiderohen në proces 19 masa.

Gjendja e zbatimit të rekomandimeve para fillimit të projektit të QTIL:

Raporti i KLSH është dërguar në Bashkinë Maliq me shkresën e KLSH, nr 239/8 datë 30.06.2016.

Bashkia Maliq, ka kthyer përgjigje në KLSH, brenda 20 ditëve nga marrja dijani me shkresën nr. 3461, datë 25.07.2016 dhe ka hartuar Plan Veprimin për zbatimin e rekomandimeve të lëna në raportin përfundimtar të auditimit, me afate konkrete dhe persona përgjegjës për realizimin e rekomandimeve.

Bashkia Maliq, nuk ka kthyer përgjigje në KLSH, mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 mujor të dhënies së rekomandimeve.

Nga auditimi ka rezultuar se 6 muaj nga lënia e rekomandimeve zbatimi i tyre ka qenë si më poshtë:

Nga **38 masa** të rekomanduara gjithsej, janë pranuar 35 masa, prej tyre janë zbatuar plotësisht 7 masa, realizuar pjesërisht 1 masë dhe nuk janë zbatuar 27 masa të rekomanduara, konkretisht:

a. Nga **15 masa organizative**, janë pranuar plotësisht 15 masa, nga të pranuarat zbatuar plotësisht 5 masa, në proces zbatimi 1 masa dhe pa zbatuar 9 masa.

b. Për masa **shpërblim dëmi janë rekomanduar 14 masa** me vlerë 25,741,355 lekë, nga të cilat pranuar 14 masa me vlerë 25,741,355 lekë, nga të pranuarat zbatuar 1 masë me vlerë 563,547 lekë dhe nuk janë zbatuar 13 masa në vlerën 22,213,808 lekë. Shuma prej 2,964,000 lekë është hequr si masë shpërblim dëmi nga ana e KLSH.

c. Janë rekomanduar **5 masa disiplinore**, nga të cilat është zbatuar 1 masë dhe janë pa zbatuar 4 masa.

d. Janë rekomanduar 3 masa administrative, gjendja e të cilave paraqitet;

-Kërkuar IMTV, 3 masa administrative “Dënim me gjobë”, nga të cilat pa zbatuar 3 masa.

- Kërkuar APP, 3 masa administrative. Nga APP Tiranë nuk ka ardhur përgjigje në lidhje me masat administrative për 3 mbikëqyrësit.

Zbatimi i rekomandimeve te KLSH në fazën e fundit të monitorimit, shtator-tetor 2017

Nga 38 masa të rekomanduara janë zbatuar plotësisht 16 masa, ndërkohë që konsiderohen në proces ose të pazbatuara 19 masa. Më konkretisht

a. Janë rekomanduar 15 masa organizative, të pranuar plotësisht edhe nga të cilat janë zbatuar 11 rekomandime, ndërkohë konsiderohen në proces zbatimi 2 masa organizative, dhe vetëm 2 masa janë të pa zbatuara.

b. Për shpërblim dëmi janë rekomanduar 14 masa me vlerë 22.266.355 lekë, të cilat janë pranuar dhe janë kontabilizuar ,prej tyre deri me datën e verifikimit 31.08.2017 janë arketuar 672.547 leke ose 3% e shumës, duke mos u arketuar edhe vlera 20.572.758 për të gjitha rekomandimet.

c. Masa për përdorim me efektivitet të fondeve është dhënë 1 rekomandim me vlerë 1.603.687 lekë, për të cilën nuk konstatuam masa për zbatim të tyre.

d.Mbështetur në nenin 58 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” janë rekomanduar 5 masa, nga e cila me “Status të Nëpunësit Civil” janë rekomanduar 3 masa disiplinore ku njëra është revokuar nga KLSH, njëra është pranuar dhe është zbatuar ndërsa tjetra është pranuar por nuk është zbatuar. Janë dhënë 2 masa disiplinore për punonjësit me “Kod Pune” ku një masë është revokuar nga KLSH dhe tjetra nuk është marë parasysh për ndryshim faktesh.

e. Janë rekomanduar 3 masa administrative (denim me gjobe) nga të cilat janë zbatuar 2 masa në vlerën 100 000 leke dhe njëra nuk është zbatuar se kompania për të cilën ishte konstatuar dëmi ekonomik fitoi gjyqin.

Raste të mos menaxhimit të aseteve të bashkisë:

Rekomandimi 8. Gjetje nga auditimi: Në auditimin mbi administrimin e sipërfaqeve pyjore dhe kullotave të ish-Komunave Moglic, Libonik, Gore dhe Pojan, u konstatua se kryejnë aktivitet shfrytëzim karriere subjekte private, duke shfrytëzuar sipërfaqe pyjore/kollusore në pronësi/përdorim të këtyre Njësive Vendore të miratuar me VKM përkatëse, gjithsej prej 45.612 ha. Këto subjekte nuk kanë bërë të mundur lidhjen e kontratave për sipërfaqet që ato kanë në përdorim, me qëllim përlllogaritjen dhe pagesën e qirasë, duke sjellë mungesë të ardhurash me efekt negativ në buxhet për vlerën 12,714,863 lekë, veprime këto në kundërshtim me ligjin “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, dhe VKM “Për përcaktimin e procedurave dhe të kriterëve të administrimit të pyllit komunal”, VKM “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, si dhe ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e Qeverisjes Vendore”.



Kullota në Gorë

8.1. Rekomandimi: Bashkia Maliq në bashkëpunim me Njësitë Administrative Moglic, Libonik, Gore, Pojan dhe Drejtorinë e Shërbimit Pyjorë Korçë, të marrë masa për evidentimin e sipërfaqeve pyjore dhe kollusore të shfrytëzueshme nga subjektet private, duke lidhur kontrata ligjore, para noterit publik duke përcaktuar dhe arkëtuar detyrimet për qiranë në vlerën 12,714,863 lekë, respektivisht:

-Shoqëria “M...” shpk për sipërfaqen 2.6 ha me vlerë **2,669,333 lekë**,

-Shoqëria “A...” shpk për sipërfaqen 8.05 ha me vlerë **5,902,530 lekë**,

-Shoqëria “V...” shpk për sipërfaqen 2.5 ha me vlerë **3,300,000 lekë**

-Shoqëria “...HEC” shpk, për sipërfaqe 0.5620 ha me vlerë **843,000 lekë**

Nga **monitorimi i projektit rezulton se:**

Shoqëria “M...” shpk dhe “V...” shpk është njohur më datë 12.01.2017 për Vendimin e kryetarit të bashkisë nr 89, datë 21.12.2016 “Për arkëtim debitorë” shoqëria “V...” shpk ka hapur proces gjyqësor në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Korçë më dt 11.11.2016

Shoqëria “A...” shpk është njoftuar për t’u paraqitur dhe lidhur kontratë, por bazuar në dokumentacionin e paraqitur, kjo shoqëri pranon që ka lejë shfrytëzimi nr 847/1 datë 03.04. 2015 por vendndoshja e lejes është fshati Floq i Bashkisë Korçë dhe jo fshati Shkozë, Bashkia Maliq

Iu kërkua Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë që mbas verifikimit të na informonte nëse pretendimi i shoqërisë “A...” qendron dhe të bëjë ndryshimin në regjistër të lejeve të miratuara aktive.

Me shkresë të MEI nr 7366 i datës 17.01.2017 “Kthim përgjigjë” thekson: “Shoqëria “MP-HEC” shpk është njoftuar dhe është lidhur kontratë qiraje “Për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor kombëtar” me nr 9669 Rep dhe Nr 5663 Kol me afat 12.12.2016-12.12.2015 dhe ka lidhur faturën për arëtim për llogari

të Bashkisë Maliq në degën e Thesarit Korçë shumë 492,470 lekë, gjithashtu ka hapur proces gjyqësor në Gjykatën Administrative të Shkallës së parë Korçë më datën 21.10.2016.”

9. Gjetje nga auditimi: Nuk janë zbatuar procedurat e pakësimit të sipërfaqeve të shfrytëzueshme nga subjektet private, siç përcaktohet në ligjin “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, dhe VKM “Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor”, si dhe VKM “Për rregullat dhe procedurat që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullor”.

9.1. Rekomandimi: Bashkia Maliq t’i kërkojë Ministrisë Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujerave, Ministrisë Energjetikës dhe Industrisë, që të marrë masa për evidentimin e sipërfaqeve të shfrytëzueshme nga subjektet private, duke zbritur nga fondi pyjorë dhe kullor këto sipërfaqe, si dhe të hartojë bilancin e përgjithshëm të sipërfaqeve pyjore dhe kullorë të mbetura.

Gjithashtu për rastet kur nuk është vepruar për zbritjen nga fondi pyjor, t’i kërkojë Agjencisë Kombëtare të Hidrokarbureve (AKBN), bllokimin e veprimtarisë të Kompanive minerare private, deri në zbritjen nga ky fond të sipërfaqeve të shfrytëzueshme nga subjektet private.

Nga monitorimi i projektit rezulton se rekomandimi është zbatuar.

Agjencia e Pyjeve dhe kullotave në Bashki në zbatim të urdhërit të Kryetarit nr. 33 datë 07.02.2017 “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH me auditimin e fundit në Bashkinë Maliq” ka vepruar:

Ka krijuar regjistrin e riskut për Agjencinë e Pyjeve dhe Kullotave me objektivat, risqet dhe masat për minimizimin e risqeve.

Ka bërë evidentimin e subjekteve private që operojnë në fondi pyjor–kullor në territorin e Bashkisë Maliq dhe me shkresë nr prot. 1705 datë 31.03.2017 Agjencia e Pyjeve dhe Kullotave në Bashki i ka dërguar informacion Ministrisë së mjedisit, tabelat për ndryshimet e kadastrës pyjore, për kontratat e lidhura, për heqjen dhe dhënien në përdorim të fondit pyjor-kullor, si dhe paksimet dhe shtesat e fondit pyjor-kullor: korrik 2016–janar 2017. Ka evidentuar subjektet që marrin në përdorim apo heqin sipërfaqe nga fondi pyjor kullor, si dhe ka hartuar bilancin e përgjithshëm të sipërfaqeve pyjore/kullorë dhe këtë informacion ia ka përcjellë Ministrisë së Mjedisit



Kullota, fshati Libonik

10. Gjetje nga auditimi: Nuk është ndjekur me përparësi zbatimi i dispozitave të Kreut VI-Monitorimi i Kontratave, mbi ecurinë e tyre, mirëmbajtjen e objektit, numrin e të punësuarve, sipërfaqen e shfrytëzueshme, etj, si dhe nuk është zbatuar VKM “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfitozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, për paraqitjen e informacionit mbi zbatimin e plan biznesit që bashkëlidhet kontratave.

10.1. Rekomandimi: Bashkia Maliq në bashkëpunim me Njësitë Administrative, të analizojë dhe monitorojë 3 (tre) kontratat e lidhura deri në fund të vitit 2015, duke parë zbatimin e plan bizneseve të paraqitura në momentin e lidhjes së tyre dhe për

rastet kur këto plane nuk kanë gjetur zbatim, të kërkojë zbatimin e plan biznesit ose prishja e tyre. Në të gjitha rastet kontratat lidhura duhet të jenë të noterizuara.

Nga monitorimi i projektit rezulton se rekomandimi nuk është zbatuar:

Për monitorimin e dy kompanive me subjekt “A...” shpk dhe subjektin k. Z.i, Bashkia Maliq informon

se me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 590, datë 01.07.2017 “Për një ndryshim të Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 41 datë 21.01.2015, pika 2 e drejta e përfaqësimit të pronarit shtet për shoqërinë “Kombinati i sheqerit” sha Maliq, kalohet nga Bashkia Maliq te Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, e drejta e monitorimit i kalon Ministrisë së Ekonomisë.

Për kontratën me subjektin ‘I...f’ nuk është kryer monitorimi

11. Gjetje nga auditimi: Në Bashkinë Maliq dhe 6 Njësitë Administrative në juridiksion të saj, u konstatua se në fund të vitit 2015 janë 238 subjekte debitorë të biznesit të madh e të vogël, të cilët nuk kanë shlyer taksat dhe tarifat vendore për shumën 5,169,000 lekë. Për vjeljen e këtyre debitorëve Zyra e Taksave Vendore nuk ka ndjekur procedurat e nevojshme ligjore për arkëtimin e debitorëve, në kundërshtim ligjin “Për sistemin e taksave vendore”, dhe ligjin ”Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

11.1. Rekomandimi: Për arkëtimin e detyrimeve tatimore nga 238 subjekte debitorë në shumën 5,196,000 lekë, të nxiren njoftim vlerësimet tatimore, duke ndjekur rrugët e mëposhtme:

a-Tu dërgohen bankave urdhrat e bllokimit të llogarive në banka, bazuar në ligjin ”Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

b-Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në Zyrën Vendore të regjistrimit të pasurive të Paluajtshme Kavajë (për pasuritë e paluajtshme).

c-Për subjektet të cilët nuk paguajnë detyrimet tatimore në afat, ndaj tyre të llogariten kamat vonesa (gjobë në masën 0,06% kamat vonesë të detyrimit në ditë por jo më tepër se 365 ditë).

d-Në rast se Bizneset private edhe pas dërgimit të urdhër bllokimeve në Bankë dhe njoftimeve zyrtare, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, të vendosen masa administrative të bëhet kallëzim penal.

Nga monitorimi i projektit rezulton se rekomandimi është zbatuar pjesërisht.

Për këtë rekomandim në Bashkinë Maliq Qendër, nga 18 subjekte që kanë detyrim në shumën 3,070,000 lekë kanë paguar 9 subjekte në shumën 234,900 lekë.

Nj. A. Libonik: 74 subjekte me detyrim 1,206,000 lekë, kanë paguar 15 biznese 391,492 lekë.

Nj.A. Pojan: 72 subjekte me detyrim 623,000 lekë, kanë paguar 72 subjekte me vlerë 623,000 lekë

Nj.A. Vreshtas: 46 subjekte me detyrim 268,000 lekë, 4 subjekte në shumën 13,400 lekë deri më 31.12.2017

Nj.A. Gorë: 12 subjekte me detyrim 129,000 lekë, kanë paguar 9 subjekte 93,385 lekë;

Pra nga detyrimi 5,296,000 lekë kanë paguar 115 subjekte në shumën 1,363,377 lekë

Të dhënat po i paraqitim në tabelë:

Emri i njësisë	Nr i subjekteve	Shuma në lekë	Arkëtuar 31.12.2016		Arkëtuar Deri më 31.03.2017		totali	
			Nr.i subjekteve	lekë	Nr i subjekteve	lekë	Nr i subjekteve	lekë
Nj.A.Maliq	18	3,070,000	5	158,000	4	76,900	9	234,900
Nj.A.Libonik	74	1,206,000	15	247,000	6	144,492	21	391,492
Nj.A.Pojan	72	623,000	72	623,000	0	0	72	623,000
Nj.A.Vreshtas	46	268,000	1	8,000	3	12,600	4	20,600
Nj.A.Gorë	12	129,000	9	93,385	0	0	9	93,385
Totali	222	5,296,000	102	1,129,385	13	233,992	115	1,363,377

Për subjektet që nuk kanë paguar detyrimin u është drejtuar të gjitha bankave me shkresë 'Urdhër bllokimi për llogaritë bankare për 80 subjekte me shkresë për 'Njoftim për vendosje të barrës së sigurisë për 80 subjekte, drejtuar DRSHTRR, Korçë.

12. Gjetje nga auditimi: Në Bashkinë Maliq dhe 6 Njësitë Administrative të kësaj Bashkie deri me datë 31.12.2015, nuk janë mbledhur debitorët familjarë për taksat e tarifave vendore në vlerën 88,258 mijë lekë, nga e cila; 10078 familje për 10 vjet nga viti 2006-2015 taksë toke në vlerën 64,752 mijë lekë dhe taksë ndërtese e tarifa të tjera vendore 8139 familje për vlerën 23,506 mijë lekë.

12.1. Rekomandimi: Drejtoria e Taksave Vendore Bashkia Maliq, të listojë në mënyrë elektronike abonmentët familjarë dhe të marrë masa për arkëtimin e taksave e tarifave me vlerë 88,258 mijë lekë, sipas të dhënave që disponon Gjendja Civile, duke dërguar njoftim vlerësimet abonmentëve familjarë me anë të Zyrës Postare, në Bashkinë Maliq dhe 6 Njësitë Administrative si më poshtë:

-Bashkia Maliq, për taksë toke në 536 familje me vlerë 161 mijë lekë dhe taksë ndërtese e tarifa vendore në 547 familje me vlerë 559 mijë lekë.

-Njësia Administrative Moglic, për taksë toke në 647 familje me vlerë 2,875 mijë lekë dhe taksë ndërtese e tarifa vendore në 766 familje me vlerë 66 mijë lekë.

-Njësia Administrative Pojan, për taksë toke në 2612 familje me vlerë 4,512 mijë lekë dhe taksë ndërtese e tarifa vendore në 2252 familje me vlerë 2,615 mijë lekë.

-Njësia Administrative Libonik, për taksë toke në 2304 familje me vlerë 36,016 mijë lekë dhe taksë ndërtese e tarifa vendore në 2265 familje me vlerë 11,802 mijë lekë.

-Njësia Administrative Gore, për taksë toke në 912 familje me vlerë 229 mijë lekë dhe taksë ndërtese e tarifa vendore në 349 familje me vlerë 1,373 mijë lekë.

-Njësia Administrative Pîrg, për taksë toke në 1384 familje me vlerë 8,435 mijë lekë dhe taksë ndërtese e tarifa vendore në 1082 familje me vlerë 2,093 mijë lekë.

-Njësia Administrative Vreshtaz, për taksë toke në 1660 familje me vlerë 12,524 mijë lekë dhe taksë ndërtese e tarifa vendore në 877 familje me vlerë 4,998 mijë lekë.

-Debitorët për taksat dhe tarifave vendore për bashkinë Maliq dhe Njësitë Administrative me datë 31.12.2015.

Nr	Nj/Adm	Tokë e ndarë sipas Ligjit. Nr familje Ha.		Sipas Bilancit datë 31.12.2015		Sipas Listave Analitike						Debitorët për taksë ndërtese pastrim ndriçimi etj.familjarët	
						Biznese Private	Debitorët e taksës së tokës 31.12.15				Spaguajnë Fare		
							Nr	lek	Famil	lekë			
		Nr.Fam	Ha	Nr	Lekë	Nr	lek	Famil	lekë	Famil	lekë	Famil	Lekë
1	Maliq	799	578.9	-	-	18	3,070	536	161	123	50	547	559
2	Libonik	3292	3862	-	-	74	1,206	2304	36,016	446	12,815	2,265	11,802
3	Pojan	3732	5053	-	-	72	623	2612	4,512	145	3,240	2252	2,615
4	Vreshtaz	2372	3458.6	-	-	46	268	1660	12,524	1045	17,656	877	4,998
5	Pîrg	1978	2125.7	-	-	0	0	1384	8,435	306	2,881	1082	2,093
6	Gore	1303	2980.9	-	-	12	129	912	229	697	6,574	349	1,373
7	Mogliçë	925	724	-	-	0	0	647	2,875	555	7,005	767	66
	Totali	14401	18783	-	-	238	5,169	10078	64,752	3317	50,221	8139	23,506

Nga të dhënat e disponueshme të Drejtorisë së të ardhurave të Bashkisë Maliq gjëndja e debitorëve për taksat dhe tarifave vendore me datë 31.12.2015 paraqitet në pasqyrën si më poshtë mijë lekë:

Nga të dhënat sipas pasqyrës si më sipër rezulton se kanë përfituar tokë sipas ligjit gjithsej 14401 familje me sipërfaqe 18783 ha dhe sipas tarifave të miratuar me vendim të këshillave të njesive të qeverisjes vendore sipas kategorive duhet të realizonin të ardhura vetëm për taksën e tokës në vlerën 28,635 mijë lekë. Rezulton se debitorët për taksën e tokës në Bashkinë Maliq së bashku me njësitë Administrative janë 10078 familje në vlerën 64,752 mijë lekë (Debitorët për taksat dhe tarifave vendore janë për periudhën 2006-31.12.2015), nuk paguajnë fare 3317



Pyjet Llozhan

familje për vlerën 50,221 mijë lekë ndërsa debitorë për taksë ndërtese dhe tarifa vendore për familjet rezultojnë se janë 8139 familje për vlerën 23,506 mijë lekë.

Debitorët e biznesit janë për 238 biznese në vlerën 5,169 mijë lekë.

Nga të dhënat rezultojnë se detyrimet për taksat e tarifën vendore nuk janë të kontabilizuara dhe nuk janë të pasqyruara në bilancet e kontabël.

Nga monitorimi i projektit rezultojnë se rekomandimi është në proces.

Në Bashki Qendër për taksë tokë kanë paguar 297 familje në shumën 199,983 lekë, për

taksë ndërtese dhe tarifa vendore kanë paguar 297 familje në shumën 353,319 lekë. Deri më datën 31.03.2017 për taksë toke 294 familje në shumën 28,545 lekë, për tarifën e tjera 294 familje në shumën 74,378 lekë

Në Njësinë Administrative Moglicë: Për taksë toke kanë paguar 92 familje në shumën 289,561 lekë, për taksë ndërtese dhe tarifa vendore kanë paguar 92 familje në shumën 275,783 lekë. Deri më 31.03.2017 për taksë toke 12 familje në shumën 30,483 lekë, për tarifën e tjera 12 familje në shumën 3,376 lekë

Në Njësinë Administrative Libonik: për taksë toke kanë paguar 1,573 familje në shumën 4,523,802 lekë, për taksë ndërtese dhe tarifa vendore kanë paguar 1,573 familje në shumën 1,473,343 lekë. Për taksë toke 182 familje në shumën 363,748 lekë, për tarifën e tjera 182 familje në shumën 154,806 lekë

Në Njësinë Administrative Gorë: Për taksë toke kanë paguar 260 familje në shumën 650,018 lekë, për taksë ndërtese dhe tarifa vendore kanë paguar 260 familje në shumën 217,838 lekë. Deri më 31.03.2017 për taksë të toke 64 familje në shumën 96,102 lekë, për tarifën e tjera 64 familje në shumën 718,890 lekë

Në njësinë Administrative Pirg: Për taksë toke kanë paguar 1,189 familje në shumën 1,654,502 lekë. Për taksë toke 123 familje në shumën 126,314 lekë, për tarifa të tjera 123 familje në shumën 20,500 lekë

Në Njësinë Administrative Vreshtas: Për taksë tokë kanë paguar 840 familje në shumën 2,866,954 lekë, për taksë ndërtese dhe tarifa vendore kanë paguar 840 familje në shumën 444,954 lekë. Për taksë toke 285 familje në shumën 281,691 lekë, për tarifën e tjera 285 familje në shumën 13,430 lekë

Në Njësinë Administrative Pojan: Për taksë toke kanë paguar 1324 familje në shumën 4,151,713 lekë, për taksë ndërtese dhe tarifavendore kanë paguar 1,324 familje në shumën 590, 866 lekë, për tarifën e tjera 143 familje në shumën 215,600 lekë

Të dhënat po i paraqitim në tabelën ngjitur.

Bashkia Maliq na informoi se Drejtoria e të Ardhurave po saktëson

Njesia	Nr i familjeve për taksë toke e tarifa të tjera	Shumë në lekë	Arkëtuar 31.12.2016		Arkëtuar Deri më 31.03.2017		Totali	
			Nr i familjeve	lekë	Nr i familjeve	lekë	Nr i familjeve	Lekë
Maliq	1,083	720,000	297	553,302	294	102,923	591	656,225
Libonik	4,569	47,818,000	1,573	5,997,145	182	518,554	1,755	6,515,699
Pojan	4,864	7,127,000	1,324	5,751,238	143	806,466	1,467	6,557,704
Vreshtas	2,537	17,522,000	840	3,311,908	285	295,121	1,125	3,607,029
Gorë	1,261	1,602,000	260	871,856	64	814,992	324	1,686,848
Pirg	2,466	10,528,000	1,189	5,456,877	123	146,814	1,312	3,603,691
Moglicë	1,413	2,941,000	92	565,344	12	33,859	104	592,203
totali		55,258,000		20,507,670		2,718,729		23,226,399

numrin e debitorëve, sepse një familje është nxjerrë disa herë debitor për vite të ndryshme apo taksa dhe tarifa të ndryshme, dhe si rrjedhojë numri i debitorëve nuk është i saktë, por i dyfishuar

2. Bashkia Prrenjas:

Të dhëna të përmbledhura:

Në fillim të projektit:Gjithsej 49 masa nga të cilat janë zbatuar 2 masa, 1 masë pjesërisht dhe 46 masa pa zbatuar.

a.Janë dhënë 24 masa organizative, nga të cilat janë pranuar plotësisht 24 masa, në proces zbatimi 1 masë dhe janë të pa zbatuara 23 masa të rekomanduara.

b.Për shpërblim dëmi janë lënë 15 masa me vlerë 21,934,000 lekë. Deri me datë 23.11.2016, është arkëtuar shuma 777,658 lekë, ndërsa shuma 21,156,004 lekë nuk është arkëtuar dhe nuk është kontabilizuar.

c. Për të ardhura të munguara është lënë një masë në vlerën 383,746,864 lekë, e pranuar dhe e pazbatuar.

d.Për 9 masat disiplinore nuk ka informacion.

Në fund të projektit:nga 49 masa gjithsej janë zbatuar 28, në proces 19 dhe 2 janë pa zbatuar.

a.Nga 24 masa administrative të rekomanduara janë zbatuar plotësisht 12 masa, ndërkohë që konsiderohen në proces 12 masa.

b-Për shpërblim dëmi janë rekomanduar 15 masa me vlerë 21 934 000 lekë, të cilat janë pranuar dhe janë kontabilizuar në ditarin e veprimeve të ndryshme nga ana e zyrës Finances prej tyre. Deri në fund të shtatorit janë arkëtuar 11 187 742 leke, duke mos u arkëtuar ende vlera 10 746 258 leke.

c.Janë rekomanduar 9 masa disiplinore të cilat janë pranuar.Janë realizuar 8 masa, dhe pa u realizuar 1 masë disiplinore.



Prrenjas

Gjendja e zbatimit të rekomandimeve para fillimit të projektit të QTIL:

Bashkia e Prrenjasit ka kthyer përgjigje pas 20 ditësh në lidhje me pranimin e rekomandimeve dhe hartimin e planit të veprimit për zbatimin e tyre. Bashkia Maliq, nuk ka kthyer përgjigje në KLSH, mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 mujor të dhënies së rekomandimeve.

Ndërkohë situata e zbatimit të rekomandimeve ishte:

Janë rekomanduar gjithsej:

a .24 masa organizative, nga të cilat janë pranuar plotësisht 24 masa, në proces zbatimi 1 masë dhe ishin të pa zbatuara 23 masa të rekomanduara.

b. Për shpërblim dëmi janë lënë 15 masa me vlerë 21,934,000 lekë, deri me datë 23.11.2016, është arkëtuar shuma 777,658 lekë, ndërsa shuma 21,156,004 lekë nuk është arkëtuar dhe nuk është kontabilizuar.

c. Për të ardhura të munguara janë lënë një masë në vlerën 383,746,864 lekë, e pranuar dhe e pazbatuar që lidhet me rekomandimet që kishte lënë auditi i mëparshëm i KLSH në vitin 2014.

d. Janë rekomanduar 9 masa disiplinore, gjendja e të cilave paraqitet;

-nga të cilat sipas “Kodit të Punës në Republikën e Shqipërisë” janë 3 masa disiplinore “Zgjidhjen e menjëhershme të kontratës së punës”, për të cilën Bashkia e Prrenjas nuk ka nxjerrë urdhra përkatës.Sipas

“Kodit të Punës” janë 4 masa disiplinore “Vërejtje me shkrim” për të cilën Bashkia Përrenjas nuk ka nxjerrë urdhra përkatës.

Zbatimi i rekomandimeve të KLSH në fazën e fundit të monitorimit, shtator-tetor 2017

Në mënyrë të përmbledhur pranimi dhe zbatimi i rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit paraqitet si me poshte:

a-Nga 24 masa administrative të rekomanduara janë zbatuar plotësisht 12 masa, ndërkohë që konsiderohen në proces 12 masa.

b-Për shpërblim dëmi janë rekomanduar 15 masa me vlerë 21 934 000 lekë, të cilat janë pranuar dhe janë kontabilizuar në ditarin e veprimeve të ndryshme nga ana e zyrës Finances prej tyre. Deri në fund të shtatorit janë arketuar 11 187 742 leke, duke mos u arketuar ende vlera 10 746 258 leke.

c.Janë rekomanduar 9 masa disiplinore, nga të cilat janë realizuar 8 masa, dhe pa u realizuar 1 masë disiplinore.

Zbatimi i rekomandimeve të auditit të mëparshëm:

Me shkresën nr. 613/9, datë 30.09.2014 të Kontrollit të Lartë të Shtetit është dërguar Raporti Përfundimtar i Auditimit, në të cilën janë rekomanduar 7 masa organizative, 5 masa shpërblim dëmi për vlerën 19,887,000 lekë.

Nga 7 masa organizative janë realizuar pjesërisht 3 masa.

Për 5 masa shpërblim është zbatuar vetëm 1 dhe nuk janë zbatuar 4 masa për një dëm me vlerë 5,789,895.

Nga Bashkia Përrenjas nuk është dërguar njoftim në KLSH mbi masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të rikërkua nga KLSH.

Kallëzim penal:

Është bërë kallëzim penal për 3 punonjës të Ish-Komunës, Qukës:

1. Z. E.V. me cilësinë e Kryetarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

2. Z. S.A. me cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

3. Z. E.K. me cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

pasi në procedurën e prokurimit “Rikonstruksion shkolla 9-vjeçare “Naim Frashëri” Pishkash, Komuna Qukës” kanë kryer veprime të kundërligjshme të cilat referuar përmbajtjes së dispozitës penale, neni 248 dhe neni 258 i Kodit Penal, mbartin elementët e veprës penale të “Shpërdorimit të detyrës” dhe “Shkeljes së barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike”, me dëm ekonomik në vlerën 2,203,961 lekë.

Ne lidhje me 3 kallëzimet penale, gjendja e tyre aktualisht është në këtë fazë: Bashkia Përrenjas, ka shkuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan e cila përmes një vendimi me nr. 299 dt.18.04.2017 ka vendosur t’i deklaroje të pafajshëm të tre personat.

Raste të përzgjedhura:

Rekomandimi 3: Bashkia Përrenjas në bashkëpunim Njësitë Administrative Qukës, Rrajcë dhe Drejtorinë e Shërbimit Pyjor, të marrë masa për evidentimin e sipërfaqeve pyjore dhe kullosore të shfrytëzueshme nga subjektet private, duke lidhur kontrata qiraje, para noterit publik, në përputhje me ligjin “Për noterinë”, duke përcaktuar dhe arkëtuar detyrimet për qiranë në vlerën 383,746,864 lekë, respektivisht:

-Subjekti “L... BL” shpk për sipërfaqen 25.4 ha me vlerë 13,581,334 lekë ,

-Subjekti “K-...2” shpk për sipërfaqe n 51.95 ha me vlerë 45,716,000 lekë,

-Subjekti “G...” shpk për sipërfaqen 166 ha me vlerë 146,080,000 lekë,

-Subjekti “N...” shpk për sipërfaqen 3.2 ha me vlerën 2,816,000 lekë,



Rrajcë

Janë arkëtuar 11.187.742 lekë ndërsa pjesa tjetër nuk gjenden pasi nuk kanë adresë

Rekomandimi 7.Gjetjet nga auditimi:Në Bashkinë Prrenjas , në ish komunën Stravaj dhe ish Komunën Qukës, kanë ushtruar aktivitetet pa qenë të regjistruar 45 subjekte. Mos regjistrimi i këtyre subjekteve në QKR, ka sjellë mos llogaritjen dhe arkëtimin e detyrimeve për Kontributet e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore në vlerën 4,565,976 lekë.

7.1. Rekomandimi:Zyra e Taksave e Tarifave Vendore, të njoftojë zyrtarisht Drejtorinë Rajonale Tatimore Elbasan dhe ti kërkojë për regjistrimin e këtyresubjekteve në QKR me qëllim arkëtimin e detyrimeve të Kontributeve për Sigurimet Shoqërore e Shëndetësore me vlerën prej 4,565,976 lekë, të cilët kanë ushtruar aktivitetet të pa licencuar.

Nga monitorimi rezulton se rekomandimi është zbatuar:

9. Gjetje nga auditimi:Nga sektori i Financës së Bashkisë Përrenjas nuk janë plotësuar ditari i veprimeve të ndryshme për mbylljen e llogarive ne fund të viteve ushtrimore, ditari i shpenzimeve të thesarit dhe libri përmbledhës i llogarive. Pozicionet financiare të paraqitura në bilancet e viteve 2014 e 2015, janë plotësuar të pambështetura në të dhënat e kontabilitetit, veprime këto në kundërshtim me ligji nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, ligji nr. 10296, datë 8.07.2010, “ Për menaxhimin financiarë dhe kontrollin”, neni 5 dhe Udhëzimi i Ministrisë Financave nr. 26, datë, 27.12.2007 “Për disa shtesa e ndryshime në Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 14, datë 28.12.2006, “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësitë që varen prej tyre”.

Nga monitorimi rezulton se rekomandimi nuk është zbatuar. Nuk është raportuar të jetë kryer asnjë veprim

15.1. Rekomandimi: Bashkia Prrenjas të marrë masat dhe të ndjekë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin të shumësprej 2,203,961 lekë, nga KVO, ish-Komuna Qukës, i përbërë nga z. E. V, Kryetar, z. S. A, anëtar dhe z. E. K, anëtar pasi në procedurën e prokurimit të fondeve me objekt “Rikonstruksion shkolla 9-vjeçare “Naim Frashëri” Pishkash, Komuna Qukës””, ka marrë vendim për skualifikimin në mënyrë të kundraligjshme të ofertës me vlerë më të ulët në shumën 2,203,961 lekë nga oferta e shpallur fituese në mënyrë të kundraligjshme.

Zbatimi: Është bërë kallëzim penal për 3 punonjës të Ish-Komunës, Qukës:

1. Z. E.V. me cilësinë e Kryetarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.
2. Z. S.A. me cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.
3. Z. E.K. me cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

Me akuzën e “Shpërdorimit të detyrës” dhe “Shkeljes së barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo

-Subjekti “B... B&B” shpk për sipërfaqen 30 ha me vlerën 26,400,000 lekë,

-Subjekti“T...”shpk për sipërfaqen 130.4 ha me vlerën 114,752,000 lekë,

-Subjekti“A...”shpk për sipërfaqen 3.3 ha me vlerën 2,299,000 lekë,

-Subjekti“K...I”shpk për sipërfaqen 2.6 ha me vlerën 1,144,000 lekë,

-Subjekti “M... K...” shpk për sipërfaqen 23 ha me vlerën 20,240,000 lekë,

-Subjekti “O...” shpk për sipërfaqen 12.4 ha me vlerën 9,093,330 lekë,

-Subjekti “M...” shpk për sipërfaqen 1.54 ha me vlerën 1,355,200 lekë

Nga monitorimi rezulton se rekomandimi është zbatuar pjesërisht.



ankande publike”, me dëm ekonomik në vlerën 2,203,961 lekë.

Ne lidhje me 3 kallzimet penale, gjendja e tyre aktualisht është në këtë fazë:

Bashkia Prrenjas, ka shkuar ne Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan e cila përmes një vendimi me nr. 299 dt.18.04.2017 ka vendosur t’i deklaroje te pafajshem te tre personat.

Si humbin paratë nga buxheti i bashkisë për shkak të qerave:

Një subjekt në Pishkash shfrytëzon një

Pishkash

sipërfaqe për gurore. Nga tabela e mëposhtme kuptohet se llogaritja e qerasështë e gabuar me një dem mbi 500 mijë lekë për bashkiën e Prrenjasit:

Në ish-Komunën Qukës (sot Njësia Administrative Qukës), kanë kryer aktivitet subjekte private për “shfrytëzim fondi pyjor dhe kullosor”, konkretisht:

Fillim	Mbarim	Sipërfaqja	Tarifa sipas VKM nr. 391, dt 21.6.06 dhe nr 1064, dt 22.12.10	Vlera sipas Komunës	Vlera sipas KLSH	Diferenca
			51,000 lek/ha/vit 78,000 lek/ha/vit			
18.11.2010	18.11.2011	1.5675 ha	51,000	37,000	79,942	42,942
18.11.2011	18.11.2012	1.5675 ha	51,000	37,000	79,942	42,942
18.11.2012	18.11.2013	1.5675 ha	78,000	37,000	122,265	85,265
18.11.2013	18.11.2014	1.5675 ha	78,000	37,000	122,265	85,265
18.11.2014	18.11.2015	1.5675 ha	78,000	37,000	122,265	85,265
Gjithsej detyrimi qiraje				185,000	526,679	341,679

3. Bashkia Elbasan:

Të dhëna të përmbledhura:

Në fillim të projektit: 81 rekomandime gjithsej, 63 janë zbatuar, 22 janë zbatuar pjesërisht ose janë në proces zbatimi dhe 6 rekomandime nuk janë zbatuar

Në fund të projektit: 81 rekomandime gjithsej, 63 janë zbatuar, 22 janë zbatuar pjesërisht ose janë në proces zbatimi dhe 6 rekomandime nuk janë zbatuar

Gjendja e zbatimit të rekomandimeve para fillimit të projektit të QTIL:

Nga verifikimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve konstatohet se, janë rekomanduar gjithsej:

a. 40 masa organizative, nga të cilat, janë zbatuar plotësisht 28 rekomandime, janë zbatuar pjesërisht 2 rekomandime, janë në proces 6 rekomandime dhe janë të pa zbatuara 4 rekomandime.

b. Për shpërblim dëmi janë lënë 21 rekomandime, nga këto, janë zbatuar 9 rekomandime, janë në proces 11 rekomandime, si dhe është zbatuar pjesërisht 1 rekomandim.

c. Janë rekomanduar 20 masa disiplinore, ku Komisioni i Disiplinës ka filluar procedurën për 2 punonjës, por nuk ka marrë vendim. Për 16 punonjësit e tjerë ju është dhënë masa disiplinore “Vërejtje”, kurse për 2 punonjës nuk ka masë..

I është kërkuar IMKT-së të vendosë masa administrative me gjobë, për 2 persona, të cilat janë zbatuar.

Gjatë auditimit rezultoi se pavarësisht nga puna e bërë, për disa nga masat e mësipërme, është mjaftuar vetëm me nxjerrjen e urdhrave për kryerjen e ndalesave, pa u shoqëruar në të gjitha rastet me padi gjyqësore për arkëtimin e vlerave të rekomanduara, për pasojë ndaj personave shkaktarë nuk ka filluar kryerja e ndalesave, duke u bërë përgjegjës për kalimin e afateve ligjore të kerkimit të dëmit, përcaktuar në nenin 115 të Kodit Civil në R.SH dhe nenit 203 të Kodit Punës në R.SH (prej 3 vjetësh) apo të parashkrimit të vendimeve (vlerave) të gjobave përcaktuar në nenin 46 të ligjit “Për kundërvajtjet Administrative“ (brenda 2 vjetësh), sipas vendimeve administrative të dënimit me gjobë.

Zbatimi i rekomandimeve të KLSH në fazën e fundit të monitorimit, shtator-tetor 2017

Bashkia e Elbasanit ka zbatuar rekomandimet deri në fund të shtatorit si më poshtë:

Janë pranuar të gjitha rekomandimet siç janë përcaktuar në vendimin e KLSH-së.

-Nga 40 masa organizative, janë zbatuar plotësisht 28 rekomandime, janë zbatuar pjesërisht 2 rekomandime, janë në proces 6 rekomandime, dhe janë të pa zbatuara 4 rekomandime.

-Nga 21 rekomandime për shpërblim dëmi, janë zbatuar plotësisht 9 rekomandime, janë zbatuar pjesërisht 1 rekomandim, janë në proces 11 rekomandime.

-Nga 20 masa disiplinore, janë zbatuar plotësisht 16 rekomandime, janë zbatuar pjesërisht 2 rekomandime, dhe janë të pa zbatuar 2 rekomandime.

Raste të përzgjedhura:

Rekomandimi 8. Gjetjet nga auditimi:

Sipas pasqyrave financiare të Bashkisë Elbasan, gjendja e debitorëve, llogaria 468 “Debitorë të tjerë”, paraqitet me një teprice debitorë në *shumën 36,041,031 lekë*, nga të cilat 33,714,563 lekë përfaqësojnë debitorë të rekomanduara nga auditimet e KLSH-së në vite por ende të pa arkëtuar:

Auditimi në vitin 2009 për 7 subjekte në vlerën 1,080,158 lekë,

Auditimi në vitin 2010 për 20 subjekte në vlerën 2,727,097 lekë,

Auditimi në vitin 2011 për 1 subjekt në vlerën 204,200 lekë,

Auditimi në vitin 2012 për 1 subjekt në vlerën 45,250 lekë,

Auditime në vitin 2014 për vlerën 29,657,858.

Nga Bashkia Elbasan, nuk janë ndjekur të gjitha procedurat ligjore për shpërblimin e dëmit për sa këto subjekte janë nxjerr debitorë duke ndikuar në përkeqësimin e tregueseve financiarë të bashkisë.

8.1. Rekomandimi: Bashkia Elbasan, Drejtoria e Financës me Drejtorinë Juridike të marr masa, të kërkoj në rrugë ligjore arkëtimi i shumës së mësipërme nga subjektet dhe personat debitor të mësipërm.

Nga monitorimi rezulton se rekomandimi është në proces. Sipas Bashkisë është përfshirë një fond në buxhet mbi ngritjen e padive në gjykatë dhe po vazhdon puna.

Rekomandimi 9. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2014, të ardhurat nga taksat dhe tarifave vendore në Bashkinë Elbasan, janë programuar në shumën 604,693 mijë lekë, realizuar 321,951 mijë lekë ose 53.2%, më pak për 282,742 mijë lekë.

Janë 629 subjekte debitorë të biznesit të vogël të cilët nuk kanë paguar detyrimet tatimore për taksat dhe tarifave vendore në shumën 7,950,897 lekë nga të cilat penaliteti është 1,570,290 lekë.

Janë 140 subjekte debitorë të biznesit të madh të cilët nuk kanë paguar detyrimet për taksat dhe tarifave vendore në shumën 44,022,950 lekë nga të cilat penaliteti është 8,996,582 leke.

Taksat dhe tarifave nga familjarët, janë programuar për shumën 67,200 mijë lekë, janë realizuar 55,006 mijë lekë ose 81.9 %, të cilat janë mbledhur nga agjenti tatimor “Elber” Shpk.

Për vitin 2015, të ardhurat nga taksat dhe tarifave vendore, janë programuar në shumën 632,632 mijë lekë, realizuar 411,152 mijë lekë ose 65%, më pak për 221,480 mijë lekë.

Janë 588 subjekte debitorë të biznesit të vogël të cilët nuk kanë paguar detyrimet për taksat dhe tarifave vendore në shumën 10,891,441 lekë nga të cilat penaliteti llogaritet 1,678,261 lekë.

Janë 131 subjekte debitorë të biznesit të madh të cilët nuk kanë paguar detyrimet taksat dhe tarifave vendore në shumën 54,734,680 lekë nga të cilat penaliteti llogaritet 10,878,517 leke.

Taksat dhe tarifave nga familjarët, janë programuar për shumën 67,200 mijë lekë, janë realizuar 56,840 mijë lekë ose 84.6 % të cilat janë mbledhur nga agjenti tatimor “Ujësjetës Kanalizime Elbasan” Sh.a (*trajtuar më hollësisht në faqet 43-55 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

9.1. Rekomandimi: Bashkia Elbasan, të marrë masat e nevojshme administrative dhe ligjore, me qëllim rritjen e performancës në mbledhjen e të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore.

Për vitin 2016 e në vazhdim, të merren masat e nevojshme për vjeljen e taksave dhe tarifave edhe në 12 njësitë administrative (ish-Komuna), përfshi taksën mbi pronësinë e tokës bujqësore, në zbatim të kërkesave të ligjit “Për sistemin e taksave vendore” dhe ligjin “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, VKM “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të pa trupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo- territorial”.

Nga monitorimi rezulton se rekomandimi është në proces. Sipas Bashkisë është përfshirë një fond në buxhet mbi ngritjen e padive në gjykatë dhe po vazhdon puna.

Rekomandimi 10. Gjetje nga auditimi: Drejtori e Tatim Taksave, nuk ka krijuar të dhënat e nevojshme për vjeljen e detyrimeve për taksat lokale në 12 njësitë administrative;

Nuk janë krijuar regjistrat përkatës për taksat për biznesin, taksat familjare, taksat për ndërtesën e banimit, taksat mbi pasurinë mbi tokën bujqësore etj., në zbatim të kërkesave të ligjit “Për sistemin e taksave vendore”, dhe ligjit “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, VKM “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të pa trupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo- territorial”.

10.1. Rekomandimi: Drejtoria e Tatim Taksave, në bashkëpunim me administratorët e njësive, të marrë masat për krijimin e bazës të dhënave për vjeljen e taksave lokale në 12 njësitë administrative të Bashkisë Elbasan në zbatim të kërkesave ligjore.

Nga monitorimi rezulton se rekomandimi është zbatuar. Agjensia e Tatimeve dhe Mbledhjes të të Ardhurave me shkresën nr.442, datë 11.11.2016 ka bërë njoftimet përkatëse për njësitë administrative dhe institucionet vartëse për evidentimin e debitorëve.

Rekomandimi 13. Gjetje nga auditimi:

-Në 4 njësitë; Gjergjan, Papër, Bradashësh dhe Shushicë, janë lidhur nga ish titullarët e komunave



Gjergjan

gjithsej 12 kontrata për dhënien me qira të aseteve të cilat janë në pronësi ose në përdorim të njësisë së qeverisjes vendore. Nga këto; 6 kontrata janë lidhur për dhënien me qira të tokës bujqësore gjithsej 42,8435 ha me afat 99 vjet dhe 6 kontrata për dhënien me qira të truallit për kompanitë celulare gjithsej 2200 m² me afat 9 vjet.

Në shumicën e rasteve, kontratat për dhënien me qira të tokës bujqësore, nuk janë lidhur në prani të një noteri, në kundërshtim me ligjin “Kodi civil i Republikës së Shqipërisë”.

-Nga Bashkia Elbasan dhe nga njësitë administrative të saj, nuk ka kontrata të lidhura

me subjektet që përdorin sipërfaqe pyjore në ushtrimin e aktivitetit për shfrytëzimin mineral sipas lejeve të miratuara nga Ministria e Ekonomisë Tregtisë dhe Energjetikës, bazuar në ligjin “Për sektorin mineral në Republikën e Shqipërisë”.

Nga të dhënat në web të Ministrisë së Ekonomisë Tregtisë dhe Energjetikës, konstatohet se deri në Shkurt të vitit 2016, në Qarkun e Elbasanit, kanë qenë efektive 23 leje për shfrytëzimin mineral.

Nga të dhënat që na u paraqitën, në njësitë administrative; Bradashësh dhe Labinot Mal, kanë ushtruar aktivitetin e tyre për shfrytëzimin mineral, (inerte argjilor dhe gëlqerore), 6 subjekte të pajisura me leje shfrytëzimi mineral duke shfrytëzuar një sipërfaqe totale 0.997 km².

Këto subjekte, nuk kanë paguar detyrimet për taksat lokale, në kundërshtim me ligjin “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar.

Nga ish komunat dhe Bashkia Elbasan, nuk janë lidhur me këto subjektet, kontrata për sipërfaqet që përdorin sipas lejes për shfrytëzimin mineral, në kundërshtim me ligjin “Për sektorin mineral në Republikën e Shqipërisë”. Nuk janë paguar detyrimet sipas tarifave të miratuara në ligjin “Për fondin kullosor” dhe VKM “Për disa ndryshime në vendimin nr. 391, datë 21.6.2006 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, të cilat për 1 vit për sipërfaqen 0,997 km², llogariten **43,868,000 lekë e ardhur e munguara për Bashkinë Elbasan.**

Njësitë Administrative dhe Drejtoria e Aseteve të Bashkisë Elbasan, nuk disponon të dhëna nëse sipërfaqet pyjore që shfrytëzohen për qëllime minerare, janë hequr nga fondi pyjor ose kullosor i qeverisjes vendore, në zbatim të kërkesave të ligjit “Për sektorin mineral në Republikën e Shqipërisë”, dhe ligjit “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, ligjit “Për fondin kullosor”, VKM “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të pa trupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territoriale”.

13.1. Rekomandimi: Drejtoria e Aseteve Pronave dhe Strehimit, në bashkëpunim me IMKT-në dhe Drejtorinë Juridike:

Të ndjekë zbatimin e kontrata për dhënien me qira të aseteve nga ish njësitë e qeverisjes vendore dhe të vlerësojë vlefshmërinë juridike të kontratave me afat 99 vjet, të lidhura pa praninë e noterit.

Të monitorohet aktiviteti i subjekteve të cilat shfrytëzojnë pasuritë minerare në njësitë administrative Bradashesh dhe Labinoti Mal sipas lejeve të shfrytëzimit të miratuara nga Ministria e Ekonomisë Tregtisë dhe Energjetikës, duke lidhur kontrata me ta për detyrimet financiare në zbatim të kërkesave të ligjit “Për fondin kullor” dhe VKM “Për disa ndryshime në vendimin nr. 391, datë 21.6.2006 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”.

Nga monitorimi rezulton se rekomandimi është në proces. Në Drejtorinë e Aseteve dhe Strehimit Nj.Administrative kanë dorëzuar kontratat e lidhura nga (ish-komunat) me subjekte fizike apo privat për vendosjen e antenave të kompanive celulare si dhe marrjen me qira të tokës bujqësore për 99 vjet. Ka përfunduar mbledhja e detyrimeve të prapambetura nga qeramarresit dhe monitorimi sipas kushteve të kontratës.

- Me Urdhër nr.572, date 11.04.2016 të Krytarit të Bashkisë është ngritur grupi i verifikimit në terren të sipërfaqe të zëna për vendosjen e antenave të operatorëve telefonike në 12 Nj.Administrative. Grupi përfundoi e konkludoi punën me procesverbalin e mbajtur më datë 09.05.2016.

-Me Urdhër nr.693 datë 10.05.2016 është ngritur grupi i punës për verifikimin në terren të subjekteve që shfrytëzojnë pasuritë e minierave, sipas lejeve të miratuara nga Ministria e Ekonomisë Tregtisë dhe Energjetikës. Grupi përfundoi e konkludoi punën me procesverbale dhe planimetri përkatëse.

13.2.2 Rekomandimi: Bashkia Elbasan, të marrë masa dhe ngrejë grup pune me specialistë përkatës të kadastrës dhe hartografë për të përcaktuar saktë statusin juridik të pasurive pyje, kullota dhe të tjera, të cilat përdoren nga subjektet që kanë marrë leje për shfrytëzimin minerare, me qëllim:

Përcaktimin saktë të llojit të pronës që ka marrë në përdorimin sipas sipërfaqes të përcaktuar në lejen e shfrytëzimit minierar për llogaritjen e detyrimeve financiare në zbatim të kërkesave të VKM “Për disa ndryshime në vendimin nr. 391, datë 21.6.2006 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”.

Për heqjen nga fondi pyjor të këtyre pasurive, në zbatim të kërkesave të kërkesave të ligjit “Për sektorin mineral në Republikën e Shqipërisë”.

Nga monitorimi rezulton se rekomandimi është në proces. Nga Drejtoria e Agjencisë së Shërbimeve Pyjore, Bujqësore, Veterinare dhe Mjedisore është ngritur grupi i punës për përcaktimin e pronës në përdorim.

Rekomandimi 24.1: Bashkia Elbasan të marrë masa, të analizojë me grup pune të veçantë, duke nxjerrë shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për mos përdorimin me efektivitet, ekonomikitet dhe eficientë të fondeve publike, për 13 procedurat e prokurimeve me efekte negative në përdorimin e fondeve publike në vlerën 58,250,305 lekë, duke vënë theksin në rritjen e vlerës së shtuar nga përdorimi i fondeve publike në shërbim të komunitetit.

Nga monitorimi rezulton se rekomandimi është në proces. Nga Bashkia Elbasan Drejtoria e prokurimeve po vazhdon puna mbi zbatimin e kësaj detyre të lënë nga KLSH.

Raste të përzgjedhura me ‘shpërblim dëmi’

Rekomandim 1.1: Të merren masat dhe të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës 15,254,310 lekë, nga operatori ekonomik Vi... Invest sh.p.k, e cila përfaqëson shumën e moszbatimit të penalitetëve për vonesën e dorëzimit të objektit: “Loti 2: Sistemim – asfaltim i rrugës “Qemal Stafa”, segmenti nga kryqëzimi i rrugës “Rinia” deri tek kryqëzimi me rrugën “Kasem Sejдини” si dhe i rrugëve lidhëse ndërmjet bulevardit “Aqif Pasha” dhe rrugës “Qemal Stafa”.

Nga monitorimi rezulton se rekomandimi është në proces. Nga Bashkia ka dalë urdhër zhdëmtimi nr.892, datë 20.07.2016 “Mbi zbatimin e rekomandimeve dhe kërkesave të Kontrollit të Lartë të Shtetit” në shumën 15,254,310 lekë, detyrimi është kontabilizuar nga financa, është bërë njoftimi, por deri në momentin e auditimit nuk ka arkëtim të detyrimit.

Rekomandim 2.1: Të merren masat dhe të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës 8,395,833 lekë, nga bashkimi i operatorëve ekonomik B... shpk & Al...sh.p.k e cila përfaqëson shumën e moszbatimit të penalitetëve, në tenderin me objekt “Sistemim asfaltim i rrugës Nusret Kokobobo dhe i shesheve te pallateve

nr. 60, 61, 62 63/1, 64/3, lagjja Emin Matraxhiu, Elbasan”.

Nga monitorimi rezulton se rekomandimi është në proces. Nga Bashkia ka dalë urdhër zhdëmtimi nr.957, datë 19.08.2016 “Mbi zbatimin e rekomandimeve dhe kërkesave të Kontrollit të Lartë të Shtetit” në shumën 8,395,833 lekë, detyrimi është kontabilizuar nga financa, është bërë njoftimi, por deri në momentin e auditimit nuk ka arkëtim të detyrimit.

Rekomandim 3: Bashkia Elbasan të kërkojë në rrugë ligjore shpërblimin e dëmit ekonomik në vlerën 7,673,345 lekë, nga kërkuesit e lejeve të përdorimit sipas Aneksit Nr. 1, bashkëlidhur, për arsye se, vlera e ndërtimit të objektit sipas preventivit të paraqitur nuk është llogaritur, duke u bazuar në manualet teknike të çmimit të punimeve të ndërtimit të miratuara me VKM-në përkatëse.

Nga monitorimi rezulton se rekomandimi është zbatuar pjesërisht. Me urdhra zhdëmtimi të veçanta është kërkuar zbatimi i detyrimit për 10 subjekte në shumën 4,704,330 lekë dhe duhet të dalin urdhër zhdëmtimet për subjektet e tjera në shumën 2,969,015 lekë.

Rekomandim 4: Nga Bashkia Elbasan, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 6,142,728 lekë pa t.v.sh nga operatori ekonomik “V..” sh.p.k. në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën për punë publike me objekt: “Rikonstruksioni i rrugës “Qemal Stafa”, segmenti nga kryqëzimi me rrugën “Rinia” deri tek kryqëzimi me rrugën “Kamber Sejдини” si dhe i rrugëve lidhëse midis bulevardit “Aqif Pasha” dhe rrugës “Qemal Stafa” loti II”, Bashkia Elbasan, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e situacionimit dhe likuidimit të punimeve të pakryera.

Nga monitorimi është gjetur se rekomandimi është në proces. Nga Bashkia Elbasan ka dalë urdhër zhdëmtimi nr.898, datë 21.07.2016 “Mbi zbatimin e rekomandimeve dhe kërkesave të Kontrollit të Lartë të Shtetit”, detyrimi është kontabilizuar nga financa në shumën 6,142,728 lekë, është bërë njoftimi, por deri në momentin e auditimit nuk ka arkëtim të detyrimit.



Bradashesh

4. Bashkia Pogradec:

Të dhëna të përmbledhura:

Në fillim të projektit: nga 96 masa gjithsej ishin zbatuar 2 masa, në proces ose pjesërisht 3 masa dhe pa zbatuar 91 masa.

Në fund të projektit: Nga 96 masa gjithsej janë realizuar 14 masa, janë në proces 68 dhe nuk janë realizuar 14 masa.

Gjendja e zbatimit të rekomandimeve para fillimit të projektit të QTIL:

KLSH-ja ka dërguar në Bashkinë Pogradec rekomandimet mbi “Raportin Përfundimtar dhe rekomandime” për zbatimin e rekomandimeve të nxjerra nga auditimi i kryer me datë 14.07.2016.

Bashkia Podradec ka kthyer përgjigje “dërgim plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve” brenda afatit 20 ditor. Bashkia nuk ka kthyer përgjigje në lidhje me zbatimin e rekomandimeve në afatin 6 mujor.

Është nxjerrë urdhëri nga kryetari i bashkisë dhe është hartuar plani i veprimit.

Realizimi i rekomandimeve deri në fund të dhjetorit.

a. Nga 25 masa organizative, janë pranuar plotësisht 25 masa, nga të pranuarat zbatuar plotësisht 1 masa, në proces zbatimi 3 masa dhe pa zbatuar 21 masë.

b. Për masa shpërblim dëmi janë rekomanduar 29 masa me vlerë 79,862,939 lekë, nga të cilat pranuar 29 masa me vlerë 79,862,939 lekë, nga të pranuarat zbatuar pjesërisht 1 masë me vlerë 5,534,203 lekë dhe nuk janë zbatuar 28 masa në vlerën 74,329 mijë lekë.

c. Janë rekomanduar 5 masa disiplinore, nga e cila me “Statusit të Nëpunësit Civil” janë rekomanduar 2 masa disiplinore, nga të cilat pranuar 2 masa. Nga të pranuarat pa zbatuar 2 masa disiplinore. Sipas “Kodit të punës” janë rekomanduar 3 masa disiplinore, nga të cilat pranuar 3 masa. Nga të pranuarat pa zbatuar 3 masa.

d. Janë rekomanduar 37 masa administrative, gjendja e të cilave paraqitet;

-Kërkuar IMTV, 5 masa administrative “Dënim me gjobë”, nga të cilat pa zbatuar 5 masa.

-Kërkuar IMTV, 2 masa administrative me gjobë në shumën 500,000 lekë dhe në shumën 200,000 lekë, nga të cilat pa zbatuar 2 masa.

-Kërkuar IMTV, 4 masa administrative me gjobë, nga të cilat pa zbatuar 4 masa.

- Kërkuar APP, 26 masa administrative. Me shkresën nr. 9093/5, datë 17.10.2016 të Agjencisë së Prokurimit Publik është dërguar Vendimi nr. 90, datë 17.10.2016 për dënimin me gjobë secilin nga anëtarët e KVO. Nga Bashkia Pogradec është pranuar por nuk është zbatuar.

Zbatimi i rekomandimeve të KLSH në fazën e fundit të monitorimit, shtator-tetor 2017

Në përfundim të auditimit mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve të dhëna, u konstatua se:

a. Nga 25 masa organizative të rekomanduara janë zbatuar plotësisht 5 masa, ndërkohë që konsiderohen në proces 13 masa. Të pazbatuara rezultuan 7 masa.

b. Për shpërblim dëmi janë rekomanduar 29 masa me vlerë 85,397,142 leke mijë lekë, të cilat janë pranuar dhe janë kontabilizuar prej tyre deri me datën e verifikimit 61,283,692 leke, janë arketuar 8,913,467 leke, duke mos u arketuar edhe vlera 76,483,675 leke

c. Mbështetur në ligjin “Për nëpunësin civil” janë rekomanduar 2 masa disiplinore, të pranuarat të dërguara Komisionit Disiplinor për Vendimarrje dhe prej tyre janë realizuar 2 masa.

Sipas kodit të punës janë rekomanduar 3 masa disiplinore, janë pranuar 3 masa, dhe pa u realizuar 3 masa disiplinore.

d. Janë rekomanduar 37 masa administrative nga të cilat 11 masa administrative IMTV (denim me gjobe) nga të cilat janë zbatuar 7 masa në vlerën 1,500,000 leke dhe janë pa u zbatuar 4 masa administrative

Po kështu për shkelje në fushën e prokurimeve i janë rekomanduar APP gjithsej 26 masa administrative, ku APP me vendimin nr 90 date 17.10.2016, ka vendosur për 26 persona denim me gjobe në vlerën 1,520,000 lekë, prej te cilava janë arkëtuar gjoba ne vleren 25,000 leke, 1 person ka fituar me vendim gjyqesor shuma 50,000 leke dhe nuk janë arkëtuar nga 25 persona shuma 1,445,000 lekë, 8 persona jane ne proces gjyqesor shuma 370,000 leke

Statusi aktual i padive penale:

Cështja e paditur nga KLSH është ende në proces hetimi nga Prokuroria, policia gjyqësore po mer provat. Ndër personat e paditur penalisht është edhe ish-kryetari I bashkisë së Pogradecit dhe ish kryetari I Komunës Bucimas

Padia penale: Bazuar në kualifikimet e neneve 248 “Shpërdorimi i detyrës” dhe 258 “Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike”, është bërë kallëzim penal për:

a. 1. Një titullar i AK dhe Tre anëtarë të KVO;

1. R.T, me detyrë ish Kryetar i Komunës Buçimas, në cilësinë e nëpunësit autorizues.

2. O.S, me detyrë Përgjegjës i Urbanistikës Komuna Buçimas, në cilësinë e Juristit të Njesisë së Prokurimit, për shkelje në 7 proceduar prokurimi.

3. E.P, me detyrë Drejtor i Burimeve e Shërbimeve Njerëzore/Jurist, në cilësinë e Specialistit në Njësinë e Prokurimit.

4. I.K, me detyrë Kryeinspektor i Përgjithshëm Vendor Komuna Buçimas, në cilësinë e Specialistit në Njësinë e Prokurimit.

a. 2. L.M, me detyrë ish-Kryetar Bashkie në cilësinë e ish-Titullarit të Autoriteti Kontraktor.

a. 3. Një mbikëqyrës punimesh;

6. B.B, (nën cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve me të cilin është lidhur kontrata për mbikëqyrjen e punimeve);

pasi kanë kryer veprime të kundërligjshme të cilat mbartin elementët e veprës penale të “Shpërdorimit të detyrës” dhe “Shkeljes së barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike”, si dhe shkelje të ligjit “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit” dhe Udhëzimit të KM “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”.

Raste të përzgjedhura:

Rekomandimi 2: Bashkia Pogradec të marrë masa, të ngrejë grup pune me ekspertë të fushës si hartografë, specialistë të pyjeve, kullotave dhe kadastrës urbane, me qëllim:

- vlerësimin e rasteve, porsa subjektet e mësipërme kryejnë aktivitetin e shfrytëzimit minerar pa lidhur kontratë me njësinë e qeverisjes vendore duke llogaritur detyrimeve kontraktuale sipas tarifave ligjore.

- lidhjen e kontratave porsa subjektet kryejnë aktivitetin e shfrytëzimit minerar, në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 10304, datë 15.07.2010 “Për sektorin minerar”, të ndryshuar neni 4.

- të kërkojë nga subjektet e gjetuar në shkelje arkëtimin e shumës 21,436,000 lekë, si dëm i llogaritur nga miratimi i lejes për shfrytëzimin minerar, pasi kanë shfrytëzuar sipërfaqet e pyjeve dhe kullotave.

Nga monitorimi është gjetur se rekomandimi është zbatuar pjesërisht.

Rekomandimi 4. Gjetje nga auditimi: KLSH ka lënë një raport auditimi me datë 2.06.2015. Nga Bashkia Pogradec, nga 45 masa organizative të rekomanduara (nga të cilat 25 masa organizative për Bashkinë Pogradec dhe 20 masa organizative për ish- komunën Cërravë), janë zbatuar 38 masa organizative dhe janë të pa zbatuara 7 masa organizative. Nga 16 masa shpërblim dëmi në shumën 28,060,238 lekë (nga të cilat 15 masa shpërblim dëmi për Bashkinë Pogradec dhe 1 masë shpërblim dëmi për ish-komunën Cërravë), janë zbatuar 5 masa duke arkëtuar shumën 403,839 lekë dhe nuk janë zbatuar 11 masa në shumën 27,656,399 lekë.

Nga 44 masa disiplinore të rekomanduara (38 masa disiplinore për Bashkinë Pogradec dhe 6 masa për ish-komunën Cërravë), janë zbatuar 38 masa dhe nuk janë zbatuar 6 masa disiplinore. Nga APP-ja janë vendosur 6 masa administrative gjobë në shumën 1,460,000 lekë të ciat nuk janë zbatuar. Mos zbatimi i rekomandimeve të KLSH, veprim në papajtueshmëri me ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".

Rekomandimi: Bashkia Pogradec të marrë masa, të hartojë program pune për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së si dhe të ndjek të gjitha procedurat ligjore dhe administrative për arkëtimin e shumës **27,656,399 lekë**.

Nga monitorimi është gjetur se rekomandimi është zbatuar pjesërisht.

Rekomandimi 6. Gjetje nga auditimi: Bashkia Pogradec për vitin 2015, të ardhurat nga taksat dhe tatimet për biznesin dhe familjet i ka realizuar në shumën 125,952 mijë lekë ose 29 % e tyre. Në Zyrën e Tatim Taksave mungojnë regjistrat për biznesin që ushtron aktivitetin në 7 ish-komuna, mungojnë të dhëna mbi numrin e familjeve për detyrimet e pa paguara si: tarifë ndriçimi, tarifë pastrim dhe gjelbërim, taksën e tokës bujqësore, si dhe ndaj debitorëve nuk janë aplikuar masat shtrënguese për urdhër bllokimi të llogarive bankare, konfiskim të pasurive etj, veprim në papajtueshmëri me nenin 22, 23, 24, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", të ndryshuar, nenin 90 dhe 93, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar dhe Kreu III, pika 1, të VKM nr. 510, datë 10.6.2015 "Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të pa trupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial".

Rekomandimi: Zyra e Taksave në Bashkinë Pogradec të marrë masa, për arkëtimin dhe të bëhen njoftim vlerësimet tatimore për 42 biznese debitorë, duke ndjekur rrugët e mëposhtme:

a. Tu dërgohen Bankave urdhrat e bllokimit të llogarive në banka, bazuar në nenin 90, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

b. Ti kërkohet Drejtorisë Rajonale të Shërbimit të Transportit vendosja e barrës siguroese, (për mjetet) dhe Zyrës Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (për pasuritë) bazuar në nenin 91 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat tatimore në R.SH" të ndryshuar.

c. Përsbjektet të cilët nuk paguajnë detyrimet tatimore në afat, bazuar në nenin 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat tatimore në R.SH" të ndryshuar, ndaj tyre të llogariten kamat vonesa (gjobë në masën 0,06% të detyrimit në ditë por jo më tepër se 365 ditë).

d. Drejtorja e taksave për mos pagesën e taksave në afat të aplikojë dënim me gjobë për pagesat e vonuara, në masën 0,06% kamat vonesë për çdo ditë vonesë por jo më tepër se 365 ditë, bazuar në nenin 114, të ligjit nr. 9920, dt.19.05.2008 "Për procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

e. Nga Drejtorja e taksave të listohen në mënyrë elektronike abonentët familjarë dhe të meren masa për arkëtimin e taksës së tokës, taksës së popullatës, sipas të dhënave që disponon Gjendja Civile, si dhe të njoftohen tatimpaguesit familjarë të Bashkisë Pogradec dhe 7 Njësitë Administrative, për të paguar detyrimin tatimor të miratuar nga Këshilli Bashkiak, nëpërmjet dërgimit të Njoftim Vlerësimit me anë të Zyrës Postare, për të gjitha llojet dhe shumën e taksave të paguara, si taksën e tokës, të banesave dhe tarifë ndriçimi, pastrim e gjelbërim.

Nga monitorimi rezulton se rekomandimi është zbatuar. Të gjithë abonentët familjarë janë listuar në mënyrë elektronike dhe është bërë inspektimi me nr. Faktik e si dhe janë shpërndarë fletë detyrimet përkatëse.

Me shkresën nr.2321prot.dt11.8.2016 është bërë bllokimi i llogarive bankare. Me shkresën nr.2319prot. dt.11.8.2016 është bërë bllokimi i mjeteve të transportit. Me shkresën nr.2320prot.dt11.8.2016 është bërë bllokimi i pasurive të paluajtshme.

Rekomandimi 7. Gjetje nga auditimi: Zyra e Tatim Taksave në Bashkinë Pogradec, për vitin 2014 nuk ka marrë në dorëzim dokumentacionin nga 7 ish-komunat, ndërsa të ardhurat janë realizuar në shumën 50,822 mijë lekë ose 12 % e planit të të ardhurave. Njësia Administrative Buçimas, nuk ka arkëtuar të ardhura në shumën 754,864 lekë, ndërsa Njësia Administrative Udenisht nuk ka realizuar të ardhura në shumën 2,290,100 lekë.



Buçimas

Për vitin 2015 nga Njësia Administrative Buçimas, nuk janë arkëtuar të ardhurat në shumën 2,861,617 lekë, si dhe nga Njësia Administrative Udenisht, nuk janë arkëtuar të ardhurat në shumën 1,295,630 lekë, veprim në papajtueshmëri me nenin 22, 23, 24, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar, nenin 90 dhe 93, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe Kreu III, pika 1, të VKM nr. 510, datë 10.6.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të pa

trupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”.

Rekomandimi: Zyra e Tatim Taksave në Bashkinë Pogradec të marrë masa, për të marrë në dorëzim dokumentacionin e tatim taksave nga 7 ish-komunat, të analizojë treguesit e realizimit të të ardhurave nga ish komunat me qëllim programimin sa më real të ardhurave të Bashkisë, si dhe të aplikoj sanksione ndaj subjekteve debitorë për taksat e pa arkëtuar, si dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e shumës 5,906,581 lekë.

Nga monitorimi rezulton se rekomandimi është zbatuar. Janë arkëtuar deri më 31 gusht 2017 shuma **5,696,816 leke**. Nga janari i 2016 janë marrë të gjitha të dhënat për subjektet në njësitë administrative

Rekomandimi 9. Gjetje nga auditimi: Bashkia Pogradec për vitin 2014-2015, detyrimet kontraktuale për sipërfaqen pyjore në 10 rasteme vlerë 24,971,892 lekë, i ka llogaritur më pak se sa tarifa e miratuar, duke lidhur kontrata me sipërfaqe më të vogël se sa miratimi i lejes minerar të shfrytëzimit të miratuar nga MEI dhe përkatësisht: Në Njësia Administrative Udenisht, në 5 raste me vlerë 5,664,506 lekë; në Njësia Administrative Çerrave, në 1 rast me vlerë 1,185,840 lekë; në Njësia Administrative Velçan, në 2 raste me vlerë 32,800 lekë dhe në Njësia Administrative Proptisht, në 2 raste me vlerë 5,602,800 lekë, veprim në papajtueshmëri me VKM nr. 391, datë 21.6.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”. (Trajtuar në faqet 240-267, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandimi: Bashkia Pogradec të marrë masa, të ngrejë grup pune me specialistë për vlerësimin e kontratave për pasuritë e dhëna me qira për shfrytëzim minerar, gurore dhe për ndërtimin e objekteve të ndryshme, duke përcaktuar statusin juridik të pronës, sipërfaqen, llojin e bimësisë etj., si dhe për rivlerësimin e detyrimeve kontraktuale. Të kërkojë nga subjektet qiramarrëse, arkëtimin e shumës 24,971,892 lekë, si diferencë e llogaritur më pak, si dhe të kërkojë anulimin e kontratave dhe riformulimin e tyre duke parashikuar penalitetet përkatëse.

Nga monitorimi rezulton se rekomandimi është zbatuar pjesërisht. Me urdhër nr.343 dt.14.12.2016 të Kryetarit për ngritjen e grupit të punës për verifikimin dhe vlerësimin e kontratave

Rekomandimi 10. Gjetje nga auditimi: Nga ish-komuna Buçimas për vitin 2014-2015, për dhënien me qira të sipërfaqeve pyjor edhe kulloror dhe për mbarështim të florës së egër, kultivim të bimëve të ndryshme dhe gjah, janë lidhur 4 kontrata me sipërfaqe 285,080 m², ndërsa dhënia me qira nuk është bërë mbi



Velçan

bazën e projekteve konkurruese, veprim në papajtueshmëri me ligjin “Për fondin kullor”, ligjin “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, UKM “Për përcaktimin e kriterëve të konkurrimit dhe procedurat e dhënies në përdorim me kontratë qiraje të fondit pyjor dhe kullor publik” (Trajtuar në faqet 240-267 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandimi: Bashkia Pogradec të marrë masa, të vlerësojë kontratat mbi dhënien me qira të sipërfaqeve pyjore dhe kullorë për mbarështim të florës së egër, kultivim të bimëve të ndryshme dhe gjah dhe të kërkojë nga subjektet përkatëse hartimin e projekteve konkurruese.

Nga monitorimi rezulton se rekomandimi është zbatuar pjesërisht.

Raste të përzgjedhura me ‘shpërblim dëmi’:

Rekomandimi 1. Bashkia Pogradec, të marrë në administrim nga ish komunat, sot Njësi Administrative të saj, kontratat të cilat kanë lidhur me subjekte të ndryshme për dhënien me qira të aseteve, në zbatim të kërkesave të VKM nr. 510, datë 10.6.2015.

-Bashkia Pogradec, të marrë masat dhe të procedojë sipas kërkesave ligjore për administrimin e kontratave për dhënien me qira të aseteve që ish komunat, kanë lidhur me të tretët dhe për vjeljen e detyrime kontraktuale në shumën **26,332,813 lekë** nga 91 subjekte sipas njësive administrative si më poshtë:

Bashkia Pogradec, për 1 subjekt në shumën 135,000 lekë;

Njësia Administrative Dardhas, për 4 subjekte në shumën 369,400 lekë;

Njësia Administrative Udenishtë, për 64 subjekte në shumën 9,471,503 lekë;

Njësia Administrative Buçimas, për 3 subjekte në shumën 3,100,000 lekë;

Njësia Administrative Cëravë, për 6 subjekte në shumën 2,272,670 lekë;

Njësia Administrative Velçan, për 5 subjekte në shumën 1,572,100 lekë;

Njësia Administrative Proptisht, për 7 subjekte në shumën 9,412,140 lekë.

Nga monitorimi rezulton se rekomandimi është zbatuar pjesërisht: Jane arketuar 8.750.817 leke. Pa arketuar 17.581.996 leke

Shembull: Kontratat me njësinë administrative Udenisht, 84 te tilla prej të cilave 64 subjekte kanë grumbulluar një detyrim afërsisht prej 9 milionë lekësh.

Rekomandimi 25: Bashkia Pogradec nëpërmjet një amendamenti të nënshkruar nga të dy palët nga vlera e kontratës lidhur datë 16.01.2015 me operatorin fitues “**Rej & Shpresa**”, për harkun kohor 5 vjeçar 2015-2020, nga vlera 166,148,333 lekë pa TVSh, të zbritet vlera **1,236,950 lekë**, pa TVSh, duke korrigjuar sipërfaqen e rrugëve të dubluara në “Lidhjen B” të kontratës me objekt: “Pastrimi, grumbullimi dhe largimi i mbeturinave publike në qytetin e Pogradecit”.

Nga monitorimi rezulton se rekomandimi nuk është zbatuar

Rekomandimi 27: Bashkia Pogradec të marrë masa, të kërkojë në rrugë ligjore dhe administrative duke ndjekur të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e shumës 10,594,800 lekë, nga operatori ekonomik “REJ”, e cila përfaqëson detyrime për marrjen me qira të fushës së depozitimit për një periudhë 5 vjeçare sipas kontratës nr. 974, datë 29.10.2014 me objekt: «Për depozitimin e mbeturinave urbane në territorin e Komunes Buçimas Pogradec, në vendin e quajtur «Luadhi i Celos».

Nga monitorimi rezulton se rekomandimi është në proces gjyqësor.

Rekomandimi 28: Bashkia Pogradec të marrë masa, të kërkojë në rrugë ligjore dhe administrative duke ndjekur të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e shumës 2,504,424 lekë pa TVSh, nga OE “REJ” shpk në cilësinë e sipërmarrësve në kontratën datë 10.12.2014 me objekt “Sistemim Sheshi Qendër Udenisht-Rruga Nacionale”, ish-Komuna Udenisht, Pogradec, për likuidimin e punimeve të pakryera.

Nga monitorimi rezulton se rekomandimi është në proces gjyqësor.

Rekomandimi 29: Bashkia Pogradec të marrë masa, të kërkojë në rrugë ligjore dhe administrative duke ndjekur të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e shumës 1,419,800 lekë pa TVSH, nga Operatori Ekonomik “ADA-CO” shpk në cilësinë e sipërmarrësve në Kontratën datë 11.11.2014 me objekt “Kënd Sportiv për shkollat e fshatrave Lin, Piskupat e Buqez”, ish-Komuna Udenisht, Pogradec, për situacionimit dhe likuidimit të punimeve të pakryera.

Nga monitorimi rezulton se rekomandimi është në proces gjyqësor.

5. Bashkia Lushnjë:

Të dhëna të përmbledhura:

Në fillim të projektit: Janë rekomanduar 25 masa dhe janë pranuar 16 masa. Konstatimet janë bërë vetëm mbi masat e pranuar. Nga 16 masa gjithsej janë zbatuar 8 masa, pjesërisht apo në proces 7 masa dhe pa zbatuar 1 masë.

Në fund të projektit: Nga 16 masa të konsideruara janë realizuar 14, në proces është një masë dhe 1 masë pa realizuar.

Në fillim të projektit: Masa për shpërblyerje të demit gjithsej janë 10 masa të rekomanduara me vlerën 10,631,933 leke. Janë nxjerrë urdhera ekzekutive dhe janë kontabilizuar vlera prej 7,788,463 leke. Nuk janë kontabilizuar pasi nuk janë pranuar rekomandimet vlera prej 3,143,470 leke. Janë arkëtuar 312,389 lekë dhe janë zbatuar

Gjendja e zbatimit të rekomandimeve para fillimit të projektit të QTIL:

Vendimi i KLSH për zbatimin e rekomandimeve është lëshuar më 17.06.2016.

Bashkia është përgjegjës 20 ditë nga ky urdhër për hartimin e planit të veprimit.

Bashkia nuk është përgjegjës 6 muaj pas lëshimit të këtij urdhëri pasi sic shkruhet në përgjigjen e dërguar KLSH nuk e kanë njohur këtë kërkesë të ligjit.

Në Bashkinë Lushnjë janë rekomanduar gjithsej 25 masa, prej tyre janë pranuar 16 masa ose në masën 64% të masave të rekomanduara. U konstatua se nga 16 masat e rekomanduara dhe të pranuar janë zbatuar plotësisht 8 prej tyre ose 50 %, pjesërisht dhe proces 7 masa ose 43.7 % dhe pa zbatuar 1 masë e cila përfaqëson 6.3 % të masave të propozuara.

Gjatë monitorimit rezultoi se pavarësisht nga puna e bërë, për disa nga masat e mësipërme, bashkia është mjaftuar vetëm me nxjerrjen e urdhrave për kryerjen e ndalesave, pa u shoqëruar në të gjitha rastet me padi gjyqësore për arkëtimin e vlerave të rekomanduara, për pasojë ndaj personave shkaktarë nuk ka filluar kryerja e ndalesave, duke u bërë përgjegjës për kalimin e afateve ligjore të kërimit të dëmit, përcaktuar nga Kodi Civil në R.SH dhe Kodi i Punës në R.SH (prej 3 vjetësh) apo të parashkrimit të vendimeve (vlerave) të gjobave përcaktuar në nenin 46 të ligjit “Për kundërvajtjet Administrative“ (brenda 2 vjetësh), sipas vendimeve administrative të dënimit me gjobë. Në disa raste proceset gjyqësore nuk ishin nisur për shkak se sasia e dëmit ishte vlerësuar më e vogël se kosto e gjyqit.

Niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve në shkallë bashkie paraqitet si më poshtë:

a. Janë rekomanduar 9 masa organizative, janë zbatuar plotësisht 6 masa, janë në proces zbatimi 2 masa dhe nuk është zbatuar një masë.

b. Për shpërblyerje të demit janë rekomanduar 10 masa me vlerë 10,631,933 lekë, nga të cilat janë pranuar plotësisht 7 të tilla me vlerë 7,488,463 lekë, nuk janë pranuar 3 me vlerë 3,143,470 lekë ose 30% e vlerës së rekomanduar, nga të pranuarat janë arkëtuar 312,389 lekë dhe janë zbatuar pjesërisht 5.

c. Nga verifikimi rezultoi se nga shuma e rekomanduar nga KLSH për vlerën 10,631,933 lekë, deri më datën 22.11.2016:

- Janë nxjerrë urdhrat ekzekutivë, janë kontabilizuar vlera prej 7,788,463 lekë
- Nuk janë kontabilizuar pasi nuk janë pranuar rekomandimet shuma prej 3,143,470 lekë.
- Janë arkëtuar në 4 raste vlera prej 312,389 lekë.

d. Janë rekomanduar 6 masa disiplinore, duke i kërkuar Kryetarit të Bashkisë Lushnjë, “Zgjidhjen e kontratës së punës”. Është refuzuar nga kryetari i bashkisë rekomandimi për zgjidhjen e kontratës së punës për punonjësit e sipërpërmendur, pasi nuk është i mbështetur në ligj dhe në prova.

-Janë rekomanduar që për 21 punonjës, të atakuar në raportin Përfundimtar të auditimit të fillojë procedura për dhënien e masave disiplinore ose administrative sipas shkallës së përgjegjësisë, të cilat janë refuzuar nga Kryetari i Bashkisë.

Zbatimi i rekomandimeve të KLSH në fazën e fundit të monitorimit, shtator-tetor 2017

a.Nga 16 masa të konsideruara janë realizuar 14 ose 88%, në proces është një masë ose 6% dhe 1 masë pa realizuar ose 6%.

b.Në lidhje me dëmin ekonomik nga vlera 10,631,933 leke e rekomanduar, janë kryer regjistrimet në kontabilitet duke mos regjistruar vlerën 3,143,470 leke.

c.Masa organizative janë gjithsej 9-masa nga të cilat janë realizuar gjithsej 7 –masa dhe në proces realizimi janë 2 masa.

d.Masa për shpërblim dëmi gjithsej janë 10 masa të rekomanduara me vlerën 10,631,933 leke .

Janë nxjere urdhera egzekutive dhe janë kontabilizuar vlera prej 7,788,463 leke.

Nuk janë kontabilizuar pasi nuk janë pranuar rekomandimet vlera prej 3,143,470 leke.

Masa për mos përdorim fondi me efikasitet u rekomanduan 2-masa.

e.Masa disiplinore:

Janë rekomanduar 2 masa të cilat përfshijnë zgjidhjen e kontratës së punës për 6 punonjës dhe për 21 të tjerë janë rekomanduar vërejtje të cilat janë refuzuar nga Kryetari i Bashkisë.

f.Masa administrative:

Janë rekomanduar gjithsej 4 masa nga të cilat nuk janë realizuar asnjë.

Zbatimi i rekomandimeve të auditit të mëparshëm:

Në lidhje me masat e rekomanduara nga KLSH në auditimin e fundit, dërguar me shkresë nr. 771/7, datë 15.12.2014 rezultoi se nuk janë vlerësuar e marrë masat e nevojshme për zbatimin e masave për shpërblim dëmi dhe ato disiplinore si dhe nga masat organizative të rekomanduara janë zbatuar vetëm 3 nga 9 të tilla. Nga 8 masa shpërblim dëmi është zbatuar vetëm 1 pjesërisht. Nga 43 masa disiplinore nuk është zbatuar asnjë. Për zbatimin e tyre, Titullari i Institucionit ka dhënë Urdhrin nr. 232, datë 23.12.2014 i cili në pjesën më të madhe nuk është zbatuar.

Statusi aktual i padisë penale:

Bashkia Lushnje ish-Komunen Karbunare: Në lidhje me kallzimin penal nr. 1187, datë 17.10.2016 bere nga KLSH, Prokuroria prane Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnje ka rregjistruar me datën 17.10.2016 procedimin penal nr. 735 për veprën penale «shpërdorim i detyrës». Në maj të vitit 2017 Prokuroria ka bere kerkese për gjykimin e çështjes në Gjykatën e Rrethit Lushnje.

Kallëzim penal për:

4 (katër) punonjës të ish-Komunës, Karbunarë.

1. z. B.N, ish-Kryetar i Komunës, Karbunarë, në cilësinë ish-titullarit të Autoritetit Kontraktor.

2. z. N.A, anëtar i komisionit të përzgjedhjes së procedurës së prokurimit.

3. z. A.D, anëtar i komisionit të përzgjedhjes së procedurës së prokurimit.

4. z. N.S, anëtar i komisionit të përzgjedhjes së procedurës së prokurimit.

II. 6 (gjashtë) punonjës të Bashkisë Lushnjë, nga të cilët 3 anëtarë të KVO dhe 3 anëtarë të njësisë prokurimit publik, si më poshtë:

1. Zj. T.K, me detyrë Nënkryetare e Bashkisë, Kryetare e KVO.

2. Zj. M.H, me detyrë Drejtoresh e Planifikimit të Territorit, anëtare e KVO.

3. Zj. J.B, me detyrë ekonomiste, anëtar i KVO dhe anëtare e NJHDT,

4. zj. K.H, me detyrë juriste, anëtare e NJHDT,

5. zj. M.L, ing. Ndërtimi, anëtare e NJHDT,

6. zj. B.K, me detyrë juriste, anëtare e NJHDT, pasi kanë kryer veprime të kundërligjshme të cilat referuar përmbajtjes së dispozitës penale, neni 248 dhe neni 258 i Kodit Penal, mbartin elementët e veprës penale të “Shpërdorimit të detyrës” dhe “Shkeljes së barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike”.

Raste të përzgjedhura:

Rekomandimi 1.Gjetje nga auditimi: Në lidhje me sistemet e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm rezultoi se veprimtaria e administratës së bashkisë nuk mbështetet në strategji zhvillimi afat mesme dhe vjetore si dhe nuk ka programuar dhe miratuar objektiva strategjik por i kryen aktivitetet me plane pune periodike për realizimin e misionit të ngarkuar me ligjin për organizimin dhe funksionimin e pushtetit vendor. Në këto kushte edhe vlerësimi dhe menaxhimi i riskut në mungesë të objektivave kryhet i pjesshëm dhe në shumë raste formal sa për të plotësuar kërkesat e kuadrit rregullator për menaxhimin financiar dhe kontrollin. Pas zgjedhjeve vendore të vitit 2015, funksionimi i administratës së bashkisë, përfshi 10 ish-komuna në strukturë si Njësi Administrative të Bashkisë, mbështetet ende në rregulloren ekzistuese si dhe, në të gjithë administratën, nuk ka gjetur zbatim ligji për statusin e nëpunësit civil.

Rekomandim: Bashkia Lushnjë të ngrejë një grup pune me drejtues dhe specialistë, me një program të mirë përcaktuar pune, për vlerësimin e situatës aktuale, përfshi dhe njësitë administrative, dhe të përgatisin mbi bazën e konkluzioneve, strategjinë afatmesme dhe atë vjetore të bashkisë me qëllim përcaktimin sa më real të objektivave që duhet të arrijë Bashkia Lushnjë si dhe planet periodike të veprimit për përmbushjen e objektivave si dhe përshtatjen e rregullores së brendshme të organizimit dhe funksionimit të bashkisë për të përfshirë në përcaktimet e saj veprimtarinë e njësisve administrative dhe masat disiplinore dhe administrative që duhen parashikuar për punonjësit në raste të shkeljeve apo mos përmbushjes së detyrave të ngarkuara. Drejtoria e Burimeve Njerëzore të marrë masa të menjëhershme për implementimin e ligjit për statusin e nëpunësit civil në administratën e Bashkisë, Lushnjë.

Nga monitorimi rezulton se rekomandimi është zbatuar:

Rekomandimi 3. Gjetje nga auditimi: Në lidhje me masat e rekomanduara nga KLSH në auditimin e fundit, dërguar me shkresë nr. 771/7, datë 15.12.2014 rezulton se nuk janë vlerësuar e marrë masat e nevojshme për zbatimin e masave për shpërbllim dëmi dhe ato disiplinore si dhe nga masat organizative të rekomanduara janë zbatuar vetëm 3 nga 9 të tilla. Nga 8 masa shpërbllim dëmi është zbatuar vetëm 1 pjesërisht. Nga 43 masa disiplinore nuk është zbatuar asnjë. Për zbatimin e tyre, Titullari i Institucionit ka dhënë Urdhrin nr. 232, datë 23.12.2014 i cili në pjesën më të madhe nuk është zbatuar.

Rekomandim: Kryetari i Bashkisë, të marrë në analizë situatën e zbatimit të Urdhrit nr. 232, datë 23.12.2014, “Për zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH në auditimin e mëparshëm”, të dalin përgjegjësitë individuale dhe ato institucionale për mos vlerësimin dhe zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH dhe të hartohet plan-veprimi specifik për vlerësimin sipas afateve administrative dhe zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH me shkresë nr. 771/7, datë 15.12.2014.

Nga monitorimi rezulton se rekomandimi është zbatuar pjesërisht.

Rekomandimi 5. Gjetje nga auditimi: Në lidhje me procedurat e prokurimit, të realizuara nga bashkia dhe njësitë vartëse kryesisht për mallra dhe ushqime të normuara me bazë numrin e fëmijëve në kopshte, çerdhe e konvikte, rezultoi se përlllogaritja e fondit limit mbështetej në evidencë të pakonfirmuar dhe jashtë realitetit dhe bashkëpunimit institucional me hallkat kompetente në administratën e bashkisë. Preventivat respektive nuk argumentonin nevojat sipas normave të kalorive që duhet të përfitojnë fëmijët si dhe nuk ishte në nivelin e duhur bashkëpunimi dhe kontrolli reciprok midis njësisve furnizuese dhe atyre shpenzuese për ushqimin dhe akomodimin e fëmijëve në kopshte, çerdhe dhe konvikte.

Rekomandim: Nga Administrata e Ndërmarrjes Pasurisë Publike dhe ajo e Kopsht- Çerdhe-Konvikteve, të hartohet një program masash për sigurimin e nivelit të duhur të menaxhimit e më andej të administrimit material, me qëllim plotësimin e nevojave të fëmijëve sipas normave të caktuara dhe standardeve përsa i përket kalorive për ushqimet nëpërmjet programimit të preventivave reale për efekt të përlllogaritjes së fondit limit

mbështetur në regjistra të protokolluar dhe inventarizuar, sidomos përsa i përket fëmijëve të regjistruar dhe përfitues të shërbimeve si dhe të instalojë bashkëpunimin dhe rakordimin periodik midis njësive administruese dhe atyre shpenzuese.

Nga monitorimi rezulton se rekomandimi është zbatuar

Rekomandimi 8. Gjetje nga auditimi: Në lidhje me planifikimin dhe realizimin e të ardhurave nga shërbimet, rezultoi se niveli i realizimit të planit, në rang institucioni është në nivele të ulëta, respektivisht 55-60%, me një rritje të lehtë prej 5% në vitin 2015, krahasuar me vitin paraardhës. U konstatua gjithashtu se shtatë zëra në taksat dhe tarifatat në tërësi, kanë realizimin nën 50% të planit vjetor të miratuar. Detyrimet debitorë ndaj bashkisë, më së shumti janë gjatë vitit 2015 dhe një pjesë e mirë e tyre me historik borxhi prej disa vjetësh. Peshën më të madhe të borxhit e kanë individët tek të cilët një pjesë e mirë janë jashtë kontrollit të Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore sa për shkak të kapaciteteve të pamjaftueshme aq edhe për shkak të ndryshimit nga subjektet të adresës së ushtrimit të aktivitetit, marrjes së një NIPTI tjetër, kalim në regjistrin pasiv, falimentim etj., faktorë të cilët e vështirësojnë deri në pamundësi kontaktimin dhe krijimin e mundësisë për përdorimin e masave shtrënguese për likuidimin e detyrimeve debitorë. Njëkohësisht është konstatuar se subjekte të biznesit që kanë detyrime të hershme të pa likuiduara ndaj bashkisë kanë marrë në vazhdimësi shërbime, edhe gjatë vitit 2015, si leje ndërtimi, kontrata për punë dhe shërbime pa i vënë para masave shtrënguese për likuidimin e detyrimeve përpara se të përfitojnë shërbime nga Bashkia.

Rekomandim: Kryetari i Bashkisë, të marrë masa për organizimin e një analize të mirë përgatitur të situatës për planifikimin dhe realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore dhe, në bazë të konkluzioneve, të studiohen mundësitë për minimizimin e faktorëve kërcënues në drejtim të evidentimit kontabël dhe në terren të subjekteve debitorë për kontaktimin e tyre, me qëllim aplikimin e metodave të parashikuara në Ligjin për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë dhe ato të përcaktuara në paketën fiskale vendore për rritjen e nivelit të mbledhjes së të ardhurave, për projeksionin real të burimeve për efekt të planifikimit dhe instalimin e bashkëpunimit të ngushtë jo vetëm midis Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore dhe strukturave të tjera brenda Bashkisë, të ngarkuara për taksat të caktuara, por dhe me institucione të treta të ngarkuara me ligj në rolin e agjentit për mbledhjen e të ardhurave për bashkinë sipas relevancës me funksionimin e tyre. Të merren masa për rritjen e bashkëpunimit midis strukturave të bashkisë, të evidentohen subjektet debitorë të biznesit dhe të mos përfitojnë shërbime në vazhdimësi pa likuiduar detyrimet ndaj bashkisë.

Nga monitorimi rezulton se rekomandimi është zbatuar

Rekomandimi 9. Gjetje nga auditimi: Në Bashkinë Lushnjë, përveç VKM për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim, nuk administrohet asnjë dokumentacion tjetër mbi përputhshmërinë e procesit të inventarizimit dhe kalimit të pronësisë si dhe të inventarizimit të tokave bujqësore. Nga auditimi rezultoi se nuk është bërë asnjë aplikim në ZVRPP Lushnjë për regjistrimin e pronave të shumicës së ish-komunave të shkrira.

Në Bashkinë Lushnjë dhe në disa ish-komuna të shkrira, në listën përfundimtare të pronave publike, shtetërore, ekzistojnë prona të llojit truall, të zëna nga subjekte private, e përcaktuar nga komisioni gjatë inventarizimit, në rubrikën 'funksioni për të cilën përdoret prona' të cilat shfrytëzohen nga privatët jashtë kontrollit dhe administrimit të së drejtës së përdorimit, në forma ligjore të njohura dhe veçanërisht asaj të dhënies me qira, të cilat, referuar çmimit minimal të dhënies me qira sipas VKM nr. 529, datë 8.6.2011 dhe VKM nr. 54, datë 5.2.2014, pronat, truall i lirë, sipas trajtimit në faqet nr. 158-175 të raportit, do të gjeneronin të ardhura për bashkinë në shumën totale prej rreth 243 milion lekë, të cilat përbëjnë të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë për periudhën objekt i auditimit.

Në përfundim të auditimit rezulton se Bashkia, nuk ka plotësisht nën kontroll situatën në lidhje me asetet e paluajtshme që ka në pronësi dhe në përdorim si rezultat i mos regjistrimit të të drejtave të pronësisë apo përdorimit, kryerjes jo në përputhje me përcaktimet ligjore të procesit të inventarizimit dhe marrjes së tyre në dorëzim, mos ushtrimit të kontroleve dhe saktësisht të kufijve të pronave, numrave të pasurisë sipas zonave përkatëse kadastrale, mos shfrytëzimit të tyre në formën e qiradhënies, përfshi dhe tokat bujqësore të pandara në dispozicion (*trajtuar në faqet nr. 158-175 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim: Bashkia Lushnjë të ngrejë një grup pune të përbërë nga specialistë të fushës, ku të

përfshihen dhe specialistë të ish-komunave , i cili në bazë të një strategjie sektoriale dhe një plani masash konkrete dhe me afate të përcaktuara të analizojë situatën e aseteve dhe të fillojë menjëherë punën për:

1. Vazhdimin me ritme më të shpejta për përgatitjen e dokumentacionit të kërkuar dhe aplikimin e njëpasnjëshëm për regjistrimin sa më shpejt të pronave që i kanë kaluar Bashkisë Lushnjë, së bashku me njësitë administrative, si dhe të verifikohet situata e pronave në bashkëpunim me ZVRPP dhe Agjencinë e ALUIZNIT për ndërtime të mundshme pa leje në pronat që i kanë kaluar bashkisë dhe që mund të jenë futur në proces legalizimi dhe, në rast se evidentohen situata të tilla, të kërkojë në rrugë ligjore rivendosjen e të drejtave të pronave në interes të bashkisë.

2. Identifikimin e gjurmës së pronave në terren, përcaktimit të kufijve dhe statusit të tyre si dhe identifikimin e tokave bujqësore të pandara në territorin nën juridiksion të bashkisë dhe njësite administrative me qëllim shfrytëzimin e këtyre burimeve në interes të bashkisë në formën e dhënies me qira.

Nga monitorimi rezulton se rekomandimi është në proces.

Raste të përzgjedhura ‘shpërblim dëmi’.

Rekomandimi 8. Gjetje nga auditimi: Vlera prej 3,957,578 lekë (pa tvsh), nga shoqëria “S...” shpk, nga të cilat shuma prej 2,405,963 lekë në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me objekt “Rehabilitimi i Fasadave në Qendër të Qytetit dhe në Rrugën “Misto Mane”, Bashkia Lushnjë, për situacionim dhe likuidim të punimeve të pakryera dhe shuma prej 1,551,615 lekë, nga të cilat vlera prej 1,293,600 lekë **për punime të pakryera të likuiduara dhe vlera prej 258,015 lekë** si pasojë e dëmeve të likuidueshme për vonesën në mbarimin e punimeve, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me objekt: “Shtrimi i Rrugëve Bujqësore me Çakull dhe objektin “Rikompozim i Lulishtes Bubullimë”, ish-Komuna Bubullimë, aktualisht Njësi Administrative e Bashkisë, Lushnje.

Rekomandim: Bashkia Lushnjë të marrë masa për kërkimin në rrugë ligjore të shpërblimit të dëmit në vlerë 3,957,579 lekë (pa tvsh) nga shoqëria “S...” shpk, nga të cilat shuma prej 2,405,963 lekë në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 4311 prot., datë 14.07.2015 me objekt “Rehabilitimi i Fasadave në Qendër të Qytetit dhe në Rrugën “Misto Mane”, Bashkia Lushnjë, për situacionim dhe likuidim të punimeve të pakryera, të trajtuara në detaje në faqet nr. 116-147 të Raportit të Auditimit dhe, shuma prej 1,551,615 lekë, nga të cilat vlera prej 1,293,600 lekë **për punime të pakryera të likuiduara dhe vlera prej 258,015 lekë** si pasojë e dëmeve të likuidueshme për vonesën në mbarimin e punimeve, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën për punë publike nr. - prot., datë 15.06.2015 me objekt: “Shtrimi i Rrugëve Bujqësore me Çakull dhe Rikompozim i Lulishtes Bubullimë”, ish-Komuna Bubullimë, aktualisht Njësi Administrative e Bashkisë, Lushnje

Nga monitorimi rezulton se rekomandimi është në proces gjyqësor

Rekomandimi 9. Gjetje nga auditimi: Vlera prej 537,390 lekë (pa tvsh), nga shoqëria “Ll...” shpk, nga të cilat (1) shuma prej 248,400 lekë në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 4015 prot., datë 19.06.2015 me objekt “Rikontruksioni i Rrugës “Vasil Bello”, Bashkia Lushnje, për situacionim dhe likuidim të punimeve të pakryera, të trajtuara në detaje në faqet nr. 116-147 të Raportit të Auditimit; (2) shuma prej 156,750 lekë, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 3822 prot., datë 09.06.2015 me objekt “Sistemim Asfaltim i Rrugës “Abdyl Korreshi”, Bashkia Lushnjë, për situacionim dhe likuidim të punimeve të pakryera, të trajtuara në detaje në faqet nr. 116-147 të Raportit të Auditimit dhe (3) shuma prej 132,240 lekë, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 3840 prot., datë 11.06.2015 me objekt “Rikonstruksion i Rrugës “Idriz Seferi”” Bashkia Lushnjë, për situacionim dhe likuidim të punimeve të pakryera.

Rekomandim: Bashkia Lushnjë të marrë masa për kërkimin në rrugë ligjore të shpërblimit të dëmit në vlerë 537,390 lekë (pa tvsh), nga shoqëria “Ll...” shpk, nga të cilat (1) shuma prej 248,400 lekë në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 4015 prot., datë 19.06.2015 me objekt “Rikontruksioni i Rrugës “Vasil Bello”, Bashkia Lushnje, për situacionim dhe likuidim të punimeve të pakryera, të trajtuara në detaje në faqet nr. 116-147 të Raportit të Auditimit; (2) shuma prej 156,750 lekë, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 3822 prot., datë 09.06.2015 me objekt “Sistemim Asfaltim i Rrugës “Abdyl Korreshi”, Bashkia Lushnjë, për situacionim dhe likuidim të punimeve të pakryera, të trajtuara në detaje në faqet nr. 116-147 të

Raportit të Auditimit dhe (3) shuma prej 132,240 lekë, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 3840 prot., datë 11.06.2015 me objekt “Rikonstruksion i Rrugës “Idriz Seferi”” Bashkia Lushnjë, për situacionim dhe likuidim të punimeve të pakryera.

Nga monitorimi rezulton se rekomandimi është në proces gjyqësor.

Rekomandimi 10. Gjetje nga auditimi: Vlera prej 936,620 lekë (pa tvsh), nga shoqëria “L...Konstruksion” shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 4581 prot., datë 19.11.2014 me objekt “Restaurimi i Ndërtesës ku u mbajt Kongresi i Lushnjës”, Bashkia Lushnje, për situacionim dhe likuidim të punimeve të pakryera, të trajtuara në detaje në faqet nr. 116-147 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Rekomandim: Bashkia Lushnjë të marë masa për kërkimin në rrugë ligjore të shpërblimit të dëmit në vlerë (pa tvsh), nga shoqëria “L...Konstruksion” shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 4581 prot., datë 19.11.2014 me objekt “Restaurimi i Ndërtesës ku u mbajt Kongresi i Lushnjës”, Bashkia Lushnje, për situacionim dhe likuidim të punimeve të pakryera.

Nga monitorimi rezulton se rekomandimi nuk është zbatuar.

Raste shpërdorimi të parasë publike:

a.Llogaritja e qerasë nën vlerën reale sipas ligjeve dhe udhëzimeve në fuqi:

Me Vendimin nr. 03, datë 29.06.2015 të Kryetarit të ish-Komunës Golem, është miratuar leja e ndërtimit nr. 174/3, datë 29.6.2015 për subjektin “Ëonderland” shpk, me objekt “Kapanone metalike të çmontueshme për mirëmbajtjen e mjeteve bujqësore dhe magazinë për mbajtjen e prodhimeve bujqësore”, me sipërfaqe trualli 2,304 m² dhe gjurmë të zënë nga struktura 2,304 m², me afat përfundimi 29.06.2016.

Me urdhër pagesë datë 08.07.2015, është llogaritur taksa e ndikimit në infrastrukturë mbështetur në vlerën e investimit të deklaruar nga subjekti në shumën 10,000,000 lekë x 3% = 300,000 lekë.

Nga auditimi i praktikës, rezulton se sipërfaqe e përgjithshme e ndërtimit është 2,304 m². Referuar ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin e territorit” neni 46, taksa e ndikimit në infrastrukturë duhej të llogaritej me çmimin referencë sipas Udhëzimit nr. 2, datë 6.8.2014 “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, për vitin 2014”, e cila për Lushnjën është 30,246 lekë/m² sip. ndërtimi, e cila është aplikuar dhe për lejen tjetër të ndërtimit të miratuar nga kjo njësi ajo me nr. 193, datë 13.05.2015. Sipas kuadrit rregullator më sipër, njësia duhet të zgjidhte vlerën më të madhe midis kostove të llogaritura me bazë çmimin referencë dhe preventivin e investimit të ri. Vlera e preventivit të investimit të ri, e deklaruar nga subjekti, është 10,000,000 lekë kurse vlera e investimit e llogaritur sipas çmimit referencë është 2,304m² x 30,246 lekë/m² = 69,686,784 lekë, dukshëm më e madhe se preventivi i deklaruar prej 10,000,000 lekë. Në këto kushte taksa e ndikimit në infrastrukturë duhet të llogaritet mbi çmimin referencë 69,686,784 x 3% = 2,090,604 lekë.

b. Mungesa e qerasë për sipërfaqe publike të zëna forcërisht nga banorët:

Pra nga auditimi i kryer rezultoi se në Ish Komunën Dushk I madh janë zënë forcërisht nga banorët Sipërfaqja totale prej 54,034m², ku nëse do ti referoheshim çmimit minimal dhe harkut kohor prej 17muajsh(objekt auditimi), rezulton se vlera prej **91,857,800 lekë** është mungesë të ardhurash për Buxhetin e Shtetit [17 muaj *(100lekë/m²*54,034m²)].

Paditë Penale QUIL ka monitoruar situatën e **padive penale** të kryera nga KLSH në prokuritë e rretheve Pogradec, Elbasan, Lushnjë: Gjithsej për 5 bashkitë janë *kallëzuar penalisht* 20 persona, nga 81 persona në 20 subjekte të kallëzuar penalisht.

Nga paditë e mësipërme: Padia e bërë për 3 ish-zyrtarët e bashkisë Prrenjës, ish-komuna Qukës, personate akuzuar kanë fituar gjyqin në gjykatën e shkallës së parë në Elbasan.

Padia e bërë për 7 ish-zyrtarët e bashkisë Pogradec dhe ish-komunave është ende në proces hetimi nga Prokuroria, policia gjyqësore po mer provat. Ndër personat e paditur penalisht është edhe ish-kryetari I bashkisë së Pogradecit dhe ish kryetari I Komunës Bucimas.

Padia e bërë nga KLSH për 10 zyrtarë dhe ish-zyrtarë të bashkisë së Lushnjës, Prokuroria prane Gjykatës

se Shkalles se Pare Lushnje ka regjistruar me daten 17.10.2016 procedimin penal nr. 735 per vepren penale «shperdorim i detyres». Ne maj te viti 2017 Prokuroria ka bere kerkese per gjykimin e ceshtjes ne Gjykatën e Rrethit Lushnje.

Si rrjedhim nga 20 zyrtarë të paditur penalisht, 3 prej tyre kanë fituar procesin gjyqësor ndërsa për 13 të tjerë vijon procedimi penal.

GJETJET DHE REKOMANDIMET:

QTIL ka monitoruar 289 rekomandime të dhëna prej KLSH në institucionet e zgjedhura për monitorim përgjatë vitit 2016.

Nga këta ka gjetur se:

në fillim të projektit ishte kjo gjendje:

82 rekomandime ishin realizuar ose 28%,

37 rekomandime ishin në process realizimi,

180 rekomandime nuk ishin realizuar ose 62%.

Nga këto të fundit kemi 12 mospranime nga bashkitë e monitoruara prej të cilave 9 nga bashkia Lushnjë.

Në fund të projektit: nga 289 rekomandime janë zbatuar plotësisht 135 rekomandime ose 47 për qind, pjesërisht 119 rekomandime ose 41% dhe pa zbatuar 35 rekomandime ose 12 për qind.

Kështu përgjatë zbatimit të projektit konstatojmë se është rritur masa e zbatimit të rekomandimeve nga 28 për qind në fillim të projektit në 47 për qind në fund të tij. Ka një rënie drastike të rekomandimeve që nuk trajtohen në dy skajet e projektit. Në fillim të projektit kemi 62 % të rekomandimeve që nuk ishin zbatuar ndërsa në fund të tij kemi vetëm 12 për qind të rekomandimeve.

Ka një rritje të rekomandimeve që janë në proces zbatimi apo janë zbatuar pjesërisht nga fillimi i projektit deri në fund të tij. Nga 12,8% në fillim të projektit trajtimi i rekomandimeve është rritur në 45%.

Trajtimi i rekomandimeve ende në proces është kryesisht i lidhur me shpërbllim dëmi apo rishikim kontratash, kontabilizim dhe arkëtim humbjesh apo shpërdorimesh, proces që kërkon kohë edhe për shkak të përfshirjes në procese gjyqësore të bashkisë me rastet e kërimit të dëmit apo mospagesave të ndryshme. Në pak raste ku rekomandimet nuk janë zbatuar bashkia është tërhequr nga procese gjyqësore për shuma të vogla parash (Lushnjë), humbje adresash (Prrenjas, Maliq), ose personat apo subjektet e përfshira në rekomandime kanë fituar procese gjyqësore në lidhje me rekomandimin.

Ligjet, vendimet dhe urdhërat e shkelura më shpesh:

Janë shkelur gjithsej 27 ligje, 13 VKM, 4 Udhëzime. Ligji “Për Pyjet dhe Shërbimin Pyjor”, ligji “Për Fondin Kullosor”, ligji ”Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës”, ligji “Për organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore”, ligji “Për prokurimet” janë shkelur më së shpeshti.

Ndërsa VKM që është zbatuar më pak është ai “Për miratimin e rregullave të prokurimit public”.

Ligjet e shkelura në mënyrë sistematike:

Ligji “Për organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore”

Ligji “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”

Ligji “Përmenaxhiminfinanciardhekontrollin”

Ligji “Përprokurimet”

Ligji “Për noterinë”

Ligji “Për planifikimin e territorit”

Ligji “Për Pyjet dhe Shërbimin Pyjor”

Ligji “Për Fondin Kullosor”,

Ligji ”Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës”

Ligji “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në republikën e Shqipërisë”

Ligji “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve shtetërore”
 Ligji “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”
 Ligji “Për Tatimin mbi vlerën e shtuar”
 Ligji “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”
 Ligji: “Për mbrojtjen e mjedisit”
 Ligji “Për lejet e mjedisit”
 Ligji “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”
 Ligji “Për Arkivat”
 Ligji “Për rregullat e etikës në administratën publike”
 Ligji “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e konfliktit të interesave”
 Ligji “Për legalizimin e zonave informale”
 Ligji “Kodi i Procedurave Administrative”
 Ligjin “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”
 Ligji “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”
 Ligji “Për kundërvajtjet Administrative”
 ligjit “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”
 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”

Lista e VKM që janë shkelur më shumë:

VKM “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të pa trupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territoriale”
 VKM “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës”.
 VKM “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”
 VKM “Për rregullat dhe procedurat që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullor”
 VKM “Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor”
 VKM “Për përcaktimin e procedurave dhe të kriterëve të administrimit të pyllit komunal”
 VKM “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e Pyjeve dhe Kullotave”
 VKM “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”
 VKM “Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave që krijojnë institucionet buxhetore”.
 VKM “Për dhënien me qira dhe emfiteozë të pasurive të ndërmarrjeve, shoqërive dhe institucioneve shtetërore”
 VKM “Mbi rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e Programit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit”
 VKM “Për administrimin, dokumentimin dhe qarkullimin vlerave materiale dhe monetare”
 VKM “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave, pyje dhe kullota, që transferohen në pronësi të njësisë së qeverisjes vendore, komuna Qukës, të Qarkut të Elbasan”

Lista e udhëzimeve që janë shkelur më shpesh:

UMF “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.
 UMF “Mbi procedurat e kryerjes së veprimtarisë së auditimit të brendshëm në sektorin publik”
 UKM “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”
 UKM “Për masat në zbatim të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit, Auditit të Brendshëm dhe Departamentit të Kontrollit të Brendshëm Administrativ dhe Antikorrupsion, në Këshillin e Ministrave, në institucionet në varësi të Kryeministrit a të ministrave”

Shkeljet e gjetura sipas përfshirjes në korrupsion apo përceptimit për akt korruptiv

Kjo e dhënë është ndërtuar duke konsideruar ambientin e shkeljes, pasojat dhe mënyrën e përfshirjes në këtë shkelje të zyrtarëve të institucioneve të monitoruara. Ne kemi analizuar vetëm shkeljet e qarta mbështetur mbi rekomandimet. Ndërtimi i grilës ka qënë i vështirë pasi në seleksionimin e shkeljeve disa prej tyre sillen edhe si shkelje me natyrë korruptive, edhe si shkelje me shkaktim dëmi, edhe si shkelje përmes shmangjes së procedurave. Duhet nenvizuar se KLSH në gjetjet dhe rekomandimet e veta nuk përmend fjalën korrupsion por teknikisht i shpërndan rekomandimet për shkeljet e gjetura sic janë cituar më sipër në ligjore, administrative, organizative, disiplinore, shkaktim dëmi dhe padi penale.

Janë marrë në analizë 289 shkelje të konstatuara nga KLSH në 5 bashkitë. Bazuar mbi perceptimin e monitoruesit por mbështetur në gjetjet e KLSH dhe rekomandimet që janë dhënë, është konstatuar një shkallë mesatare apo e lartë e shkeljeve me natyrë korruptive në krahasim me ato që lidhen me shkelje për shkak të dobësive ligjore apo për shkak të dobësive organizative:

Bashkia Maliq: Nga 38 rekomandime, 12 prej tyre ishin për shkelje që për shkak të gabimeve ligjore; 14 për shkak të dobësive organizative dhe 12 si mundësi për korrupsion.

Bashkia Pogradec: Nga 96 rekomandime, 6 prej tyre ishin shkelje për shkak të gabimeve ligjore; 25 për shkak të dobësive organizative dhe 23 si mundësi për korrupsion. Të tjerat lidheshin me masa disiplinore apo administrative për punonjës të bashkisë apo njësive administrative.

Bashkia Prrenjas: Nga 49 rekomandime, 13 prej tyre ishin shkelje për shkak të gabimeve ligjore; 17 për shkak të dobësive organizative dhe 16 si mundësi për korrupsion. Të tjerat lidheshin me masa disiplinore apo administrative për punonjës të bashkisë apo njësive administrative.

Bashkia Elbasan: Nga 81 rekomandime, 25 prej tyre ishin shkelje për shkak të gabimeve ligjore; 18 për shkak të dobësive organizative dhe 21 si mundësi për korrupsion. Të tjerat lidheshin me masa disiplinore apo administrative për punonjës të bashkisë apo njësive administrative.

Bashkia Lushnjë: Nga 25 rekomandime, 9 prej tyre ishin shkelje për shkak të gabimeve ligjore; 5 për shkak të dobësive organizative dhe 11 si mundësi për korrupsion.

Në total kemi: shkelje që lidhen me gabime ligjore 65; shkelje që lidhen me dobësi organizative, 77; dhe shkelje që lidhen me mundësi për korrupsion, 83.

Për rekomandimet e papërfshira në llogaritje nuk ka përcaktim. Në përgjithësi këto përfshihen në masa disiplinore apo administrative si dhe shkaktim dëmi për arsye neglizhence.

Monitoruesit nuk kanë mbajtur shënim rastet kur një shkelje me natyrë korruptive ishte ndërkohë edhe me shkaktim dëmi apo edhe me shkelje procedure pavarësisht se kishte raste të tilla.

Shkeljet më tipike të bashkive që janë gjetur nga monitorimi:

Më poshtë listohen disa nga shkeljet më tipike për institucionet:

Nuk është zbatuar plani i hartuar për menaxhimin e mbarështimin në pyje, kullota, livadhe, lidhur me kryerjen e shërbimeve mbarështuese dhe vjeljen e produkteve drusore, kullosore, produkteve dytësore si bimësi të ndryshme dhe të shërbimeve çlodhëse etj, për krijimin e të ardhurave dytësore të cilat do të siguronin zhvillim të qëndrueshëm, burime të ardhurash dhe vënien në efencë të plotë të këtyre resurseve.

Nuk është bërë i mundur realizimi i të ardhurave nga përdorimi i fondit pyjor (prekje e druve).

Nuk është kryer inventarizim kadastral pyjor me synim evidentimin e përditësimin e fuqisë lëndore,

fuqisë kullimore, bimore, aftësisë së funksionit mbrojtës (për pyjet mbrojtës), veprime në kundërshtim me ligjin “Për Pyjet dhe Shërbimin Pyjor”, të ndryshuar, dhe me Manualin e Mbarështimit të Pyjeve.

Nuk është mbajtur bilanci i fondit të tokës shprehur në sipërfaqe në tërësi, ndarë në fondin e tokës bujqësore, fondin e tokës së zënë me pyje, fondin e tokës së zënë me kullota e livadhe dhe fondin e tokës-truall.

Bashkitë karakterizohet nga menaxhimi i dobët i aseteve materiale, inventareve, aktiveve. Ka veprime me natyrë korruptive ose klienteliste sic janë copetimi i fondeve për të shmangur procedurat e prokurimit të hapur, dështimi i prokurimeve mbi një herë për të vijuar me procedura më konservative të prokurimit sic është prokurimi me zgjedhje.

Shkelje në listëpagesa, paguhen këshilltarë pa u paraqitur në mbledhje.

Nuk ka rregullore për përdorimin e fondeve nga të ardhurat.

Mungojnë faturat për shërbimet e ofruara, por edhe në rastet kur ka fatura, ato janë të paplotësuara, nuk përmbajnë të dhënat e blerësit, nuk përmbajnë nënshkrimet e shitësit dhe të blerësit, as kodet identifikues të blerësit.

Ka emërime jashtë kriterit, disa vende pune kërkojnë punonjës me ekspertizë të konfirmuar.

Miliona lekë naftë të shpenzuar pa dokumentacion, mungon disiplina financiare, urdhër shpenzimet pa numër dhe pa datë.

Subjektet e biznesit të vogël nuk kanë bërë pagesa e taksave dhe tarifave

Marrja në dorëzim e punimeve të ndërtimit, shërbimeve të kryera dhe e marrjes së mallrave e materialeve në dorëzim, ishte bërë pa ngritur komision.

Amulli në regjistrimin e pasurisë

Të ardhurat e programuara nga segmenti familjarë, për tarifën e ndriçimit, pastrimit dhe gjelbërimit, pagesën e ujit si dhe taksën e pasurisë nuk janë mbledhur. Në ndonjë rast mungonte edhe lista e familjarëve që kanë detyrimin e pagesës.

Standarte të pacentralizuara të çmimeve dhe standarteve të ulëta të zbatimit të projektit. Standarte të dyfishta në vendosjen e çmimeve të referencës, përkatësisht janë aplikuar dhe çmime referuar manualit të çmimeve të miratuar, dhe çmimet sipas udhëzuesve të donatorit.

Nuk është përmbushur investimi.

Gjetjet:

QTIL ka monitoruar 289 rekomandime të dhëna prej KLSH në institucionet e zgjedhura për monitorim përgjatë vitit 2016.

Nga këta ka gjetur se:

Në fillim të projektit ishte kjo gjendje:

82 rekomandime ishin realizuar ose 28%,

37 rekomandime ishin në process realizimi, ose 12.8%

170 rekomandime nuk ishin realizuar ose 58.8%.

Nga këto të fundit kemi 12 mospranime nga bashkitë e monitoruara prej të cilave 9 nga bashkia Lushnjë.

Në fund të projektit: nga 289 rekomandime janë zbatuar plotësisht 135 rekomandime ose 47 për qind, pjesërisht 119 rekomandime ose 41 për qind dhe pa zbatuar 35 rekomandime ose 12 për qind.

Kështu përgjatë zbatimit të projektit konstatojmë se është rritur masa e zbatimit të rekomandimeve nga 28 për qind në fillim të projektit në 47 për qind në fund të tij. Por ka një rënie drastike të rekomandimeve që nuk trajtohen në dy skajet e projektit. Në fillim të projektit kemi 58.8 % të rekomandimeve që nuk ishin zbatuar ndërsa në fund të tij kemi vetëm 12 për qind të rekomandimeve.

Ka një rritje të rekomandimeve që janë në proces zbatimi apo janë zbatuar pjesërisht nga fillimi i projektit deri në fund të tij. Nga 12,8% në fillim të projektit trajtimi i rekomandimeve është rritur në 41%.

Trajtimi i rekomandimeve ende në proces është kryesisht i lidhur me shpërblim dëmi apo rishikim

kontratash, kontabilizim dhe arkëtim humbjesh apo shpërdorimesh, proces që kërkon kohë edhe për shkak të përfshirjes në procese gjyqësore të bashkisë me rastet e kërimit të dëmit apo mospagesave të ndryshme. Në pak raste ku rekomandimet nuk janë zbatuar bashkia është tërhequr nga procese gjyqësore për shuma të vogla parash (Lushnjë), humbje adresash (Prrenjas, Maliq), ose personat apo subjektet e përfshira në rekomandime kanë fituar procese gjyqësore në lidhje me rekomandimin.

Kë rritje të zbatimit të rekomandimeve mes auditit të mëparshëm dhe auditit më të fundit. Rastet e përzgjedhura Lushnja dhe Prrenjasi.

-QITL ka monitoruar situatën e **padive penale** të kryera nga KLSH në prokuritë e rretheve Elbasan, Pogradec dhe Lushnjë: Gjithsej janë *kallëzuar penalisht* 20 persona.

Të gjitha bashkitë e monitoruara nuk kishin dhënë përgjigje brenda 6 muajsh nga urdhri i KLSH. Ato u përgjigjën vetëm në shtator, pas këmbënguljes së projektit dhe kërkesës së llogarisë nga ana e KLSH

Në përgjithësi kryetarët e bashkive nxjerrin urdhëra për zbatimin e rekomandimeve por më pas nuk ka një kontroll rreth zbatimit të urdhërit

Shumë prej kompanive të kontraktuara në investime publike janë paguar për punime të pakryera.

Nga të dhënat rezulton se detyrimet për taksat e tarifatat vendore nuk janë të kontabilizuara dhe nuk janë të pasqyruara në bilancet kontabël.

Zyra e Administrimit të Aseteve, Lejeve dhe Autorizimeve në disa bashki nuk disponojnë të dhëna mbi gjendjen e asetëve në njësitë administrative të saj.

Nuk disponohen të dhëna mbi vendimet që kanë marrë këshillat e ish komunave për pronat që i kanë miratuar për ti marrë në pronësi.

Nuk ka të dhëna mbi statusin juridik të pronave, mbi kontratat që ish njësitë e qeverisjes vendore kanë lidhur me të tretë për dhënien me qera të asetëve, mbi vjeljen e detyrimeve kontraktore, gjendjen e debitorëve etj.

Nuk disponohen të dhëna lidhur me vjeljen e taksave lokale dhe gjendjen e debitorëve të trashëguara nga ish njësitë e qeverisjes vendore për bizneset, taksat dhe tarifatat familjare, taksat për tokën bujqësore etj.

Nuk disponohen të dhëna mbi numrin e familjeve debitore për cdo ish njësi e qeverisjes vendore sot njësi administrative.

Shpesh nuk ka rakordim me ZVRPP, për asetet në pronësi, pasi nuk është marrë në dorëzim harta treguese e objekteve pronë e Bashkisë. Nuk ka të dhëna për kryerjen e veprimeve kontabile për objektet, trojet, tokat bujqësore, pyjeve dhe kullotave, të kaluara në pronësi.

Nuk ka të dhëna të plota për trojet private dhe ato shtetërore të lira ose të zëna nga ndërtimet pa leje për qëllime banimi ose biznesi, pasi mungon listimi i sipërfaqeve të trojeve.

Nuk është ngritur komision për verifikimin, marrjen në dorëzim me dokumentacion shoqëruar nga institucionet që i kanë pasur në administrim, vlerësimin e gjendjes reale të tyre dhe nëse janë të zaptuara nga të tretë, si dhe regjistrimin në ZVRPP dhe kontabilitet.

Nuk ka dosje për çdo subjekt, ku të jenë raportet teknike, miratim leje, kontrata, sipërfaqe e dhëna, plani i mbarështimit, si dhe ndjekjen e zbatimit të lejeve të shfrytëzimit të karriera në piketat e caktuara.

Nuk ka plan të mbarështimit të pyllit komunal, të miratuar nga këshilli i njësisë së qeverisjes vendore.

Nuk ka raste ku të jenë ndëshkuar subjekte private apo persona fizik për dëmtimin e pyjeve e kullotave

Bashkia lëshon certifikata për kryerje biznesesh por më pas nuk i ndjek ato. Bizneset e pajisur me certifikatë nuk regjistrohen në QKR duke mos paguar taksën për biznesin e vogël si dëm për bashkinë dhe duke mos paguar tarifatat për sigurimet si dëm për buxhetin e shtetit.

Rekomandimet e KLSH janë ndjekur nga një plan veprimi për zbatimin e tyre shoqëruar me urdhëra të brendshëm.

Projekti konstatoi diferenca të vogla në pranimin dhe vlerësimin e zbatimit të rekomandimeve mes bashkive dhe KLSH. Megjithatë bashkia Lushnjë dhe Pogradec kanë raste kontestimi dhe nuk kanë pranuar disa rekomandime.

Projekti konstatoi diferenca mes vlerësimit të KLSH dhe bashkive për statusin e rekomandimeve të cilat vijnë për shkaqet në vijim:

-konsiderojnë se kanë zbatuar rekomandimet me fillimin e zbatimit të tyre
-rekomandimet në proces konsiderohen si rekomandime të zbatuara
-disa rekomandime nuk kanë përcaktim të qartë dhe institucionet e kanë të lehtë të manovrojnë rreth zbatimit të tyre

-ka këndvështrime të ndryshme lidhur me shkeljet ligjore të konstatuara dhe lidhur me thellësinë e zbatimit të rekomandimit

-disa rekomandime janë të përcaktuara “në vijimësi” cfarë e bën subjektive kohën e plotësimit të tyre
-tek vlerësimi i rekomandimeve si zbatim i “pjesshëm”, vërehet se shpesh janë në kundërshtim të plotë me rekomandimet e KLSH.

-në lidhje me masat për shpërblim dëmi, institucionet ankohen për vështirësinë në mbledhjen e këtij shpërblimi në kohë (*përfshihen procese gjyqësore, procese animimi dhe nevojitet feedback nga disa institucione*).

Zbatimi i plotë i rekomandimeve shpesh varet nga politika dhe vullneti i titullarit(*masa administrative*), ose nga referime nga institucionet qendrore të cilat nuk janë unike për të gjitha bashkitë (*rasti i shpërblimit të këshilltarëve komunalë dhe bashkiakë, përgjigja e Ministrisë së Cështjeve Vendore*).

Disa nga masat për shpërblim dëmi bashkia është mjaftuar vetëm me nxjerrjen e urdhrave për kryerjen e ndalesave, pa u shoqëruar në të gjitha rastet me padi gjyqësore për arkëtimin e vlerave të rekomanduara, për pasojë ndaj personave shkaktarë nuk ka filluar kryerja e ndalesave, duke u bërë përgjegjës për kalimin e afateve ligjore të kërimit të dëmit, përcaktuar në nenin 115 të Kodit Civil në R.SH dhe nenit 203 të Kodit Punës në R.SH (prej 3 vjetësh) apo të parashkrimit të vendimeve (vlerave) të gjobave përcaktuar në nenin 46 të ligjit “Për kundërvajtjet Administrative“ (brenda 2 vjetësh), sipas vendimeve administrative të dënimit me gjobë.

Ende ka rekomandime që janë evazive, por në një numër shumë të vogël krahasuar me monitorimin e vitit 2015.

KLSH ka dhënë disa rekomandime për largimin nga shërbimi civil për zyrtarë që tashmë janë larguar nga ky shërbim.

Disa prej rekomandimeve të vitit 2015 vijuan të ishin në fuqi për institucionet gjatë vitit 2017 pasi ende nuk i kanë përmbushur.

Është përpunuar një format i përbashkët i raportit të rekomandimit. Kjo ka lehtësuar kryerjen e tij qoftë nga zyrtarët e audituar, qoftë edhe zyra të interesuara rreth tij apo mediat.

Ka shpesh rekomandime që për shkak të natyrës së tyre ato zbatohen në proces ose jepen që të zbatohen në vijimësi. Këto lloj rekomandimesh kanë vështirësi në matje dhe për shkak të subjektivitetit të tyre krijojnë diferenca mes KLSH dhe institucionit lidhur me zbatimin e tyre.

Nuk është e qartë nëse verifikimi i rekomandimeve bëhet nga të njëjtit persona që kanë bërë rekomandimet.

Rekomandimet

Për bashkitë:

Bashkitë të zbatojnë modele dhe struktura që sigurojnë mbledhjen e të ardhurave nga asetet e saj si kullota, pyje, toka dhe ndërtesa. Kjo sjell të nevojshme rikstrukturimin e drejtorive të aseteve në bashki, rishikimin e të gjitha kontratave dhe krijimin e një linje të pagesave që monitorohet çdo muaj shoqëruar kjo me masa të menjëhershme reaguese në rast të moszbatimit të kontratave.

Zyrat që kryejnë mbledhjet e taksave dhe tatimeve lokale, tarifrat që menaxhohen nga pushteti lokal si taksa mbi tokën, ujësjellësi në disa raste etj duhet të ndërtojnë një database lehtësisht të operueshme me pajtimtarët apo familjet duke i dhënë mundësi zyrës të konstatojë mënjëherë mungesën e pagesave.(10 vjet pa kryer asnjë pagesë dhjetra mijëra familje)

Bashkitë të ndërtojnë një fushatë ndërgjegjësimi përmes mediave lokale dhe mjeteve të tjera të informimit si rrjete sociale për nevojën dhe dobinë e pagesës së taksave familjare.

Të ngrihet një strukturë e qëndrueshme në bashki e cila objekt te posacem te punes te saj te kete ndjekjen e realizimin e rekomandimeve te Kontrollit te Larte te Shtetit.

Bashkitë të publikojnë ne faqen e saj ne internet, raportin e auditimit te Kontrollit te Larte te Shtetit, e krahas tij te publikoje edhe rezultatet konkrete te punes se kryer ne zbatim te rekomandimeve. Bashkia e Lushnjës e ka bërë ndërkohë.

Sugjerojmë përdorimin e metodes se punes me grupunonjesish per djekjen dhe zbatimin e rekomandimeve dhe jo aplikimin e metodes se deri tanishme ku ndjekja e rekomandimeve u caktohet personave te vecante te cilet ne faza te ndryshme te procedurave administrative duhet te dalin jashte profilit te tyre profesional. Ngritja e grupit te punes do te sjelle me teper efektivitet.

Për KLSH:

Bashkitë dhe KLSH duhet të konsultojnë sa më shpejt rekomandimet ku nuk ka përputhje mes dy institucioneve duke përpiluar me shpejtësi observacionet dhe komentet mbi to. Pas përmbylljes së këtij procesi në pak kohë atëherë rekomandimet e pranura duhet të zbatohen plotësisht.

Auditimi i dokumentacionit merr shumë kohë ndërkohë që kjo mund të bëhet me strukturat e auditit në institucion dhe në bazë të një analize risku audituesit nga KLSH mund të zgjedhin pjesë për të testuar funksionimin e procesit të menaxhimit të shumave të vogla në institucion.

Ende KLSH ka raste kur auditon vlera shume te vogla.

(Rasti i Elbasanit: 21. Gjetje nga auditimi: Me urdhër shpenzim nr. 298, datë 26.05.2015 është paguar personi fizik G.S. për vlerën 9,600 lekë për shërbime të kryera sipas procedurave për blerje dhe shërbime me vlera të vogla. Është paguar më tepër se sa oferta e paraqitur *për vlerën 1,600 lekë*, në kundërshtim me kërkesa e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik“ i ndryshuar dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik“ i ndryshuar. *21.1.Rekomandimi: Të bëhet kontabilizimi dhe të ndiqen të gjitha procedurat ligjore për shpërblimin e dëmit në vlerën 1,600 lekë nga personi fizik G.S.)*

Të bëhen trainime në lidhje me ligjet dhe VKM të vilat shërbejnë për menaxhimin më të mirë të aseteve.

KLSH duhet të krijojë mundësinë e tryezave që të koordinojnë masat për zbatimin e rekomandimeve me institucionet e monitoruara

KLSH duhet të programojë një cikël trainimesh në administratën publike vecmas në bashki në lidhje me zbatimine ligjit për KLSH, nenet e lidhura me rekomandimet. Disa zyra nuk e njohin mirë ligjin. Mungesa e përgjigjes 6 muaj pas urdhërit të kryetarit të KLSH është ndjekur nga justifikimi se nuk e njihnin këtë kërkesë.